

2018

RAPO RTI VJETOR

AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHETIT



AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHETIT

2018

RAPORTI VJETOR

**AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI
DOKUMENTET E ISH SIGURIMIT TË SHETIT**



AUTORITETI PËR I FORMIMIN MBI
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHETIT

PËRMBAJTJA

Hyrje.....	7
1. Mesazhi	8
2. Kuadri ligjor	10
3. Respektimi dhe plotësimi i detyrimeve ndërkombëtare, Përbushja e rekomandimeve të “Progres Raportit” të BE-së për Shqipërinë nga AIDSSH	13
4. Zbatimi i rezolutës së Kuvendit për vlerësimin e veprimtarinë së AIDSSH-së për vitin 2017.....	17
5. Veprimtaria e AIDSSH-së për vitin 2018.....	26
5.1 Aktiviteti i institucionit	27
5.1.1 Arkivi	27
5.1.2 Informacioni.....	32
5.1.3 Hulumtimi Shkencor dhe Edukimit Qytetar	41
5.1.4 Siguria dhe Zhvillimi Teknologjik më efikase për zgjidhjen e tyre nga Kuvendi dhe Këshilli i Ministrave	48
5.2 Objektivat e institucionit për vitin 2019.....	53
5.3 Synimet për të ardhmen	54
5.4 Parashikimi tre vjeçar në lidhje me vizionin e institucionit.....	54
6. Ndryshimet në kuadrin rregullator për vitin 2018 dhe efektet e tyre.....	55
7. Të dhëna dhe shifra mbi aktivitetin e AIDSSH-së të krahasuara me vitin 2017	58
8. Vlerësimi për nivelin e zbatimit të detyrimeve ligjore nga AIDSSH dhe përgjegjësitë në rastet kur ligji është shkelur apo nuk është konsideruar	61
9. Statusi në zbatim të rekomandimeve që institucione të tjera kushtetuese ose të pavarura kanë dhënë për AIDSSH-në.....	63
10. Nevoja për ndryshime në kuadrin ligjor që rregullon veprimtarinë e AIDSSH-së.....	65
11. Organizimi i brendshëm i institucionit	68
12. Të ardhurat dhe shpenzimet, përfshirë fondet e përfituara nga donatorët.....	74
13. Kallëzimet penale dhe proceset gjyqësore.....	78

HYRJE

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit është krijuar me Ligjin nr. 45/2015, "Për të drejtën e informimit mbi dosjet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", për të bërë të mundur ushtrimin e së drejtës nga çdo i interesuar për informimin mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, nëpërmjet një procesi demokratik dhe transparent, mbrojtjes së personalitetit të individit, si dhe unitetit e pajtimit kombëtar.

AIDSSH është institucion i pavarur, përgjegjës për mbledhjen, administrimin, përpunimin e dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit dhe për sigurimin e aksesit në ta, për të gjitha subjektet e ligjit nr. 45/2015, në funksion të edukimit të publikut dhe mbështetjes së vlerave demokratike të drejtësisë, së vërtetës, pajtimit dhe përgjegjësisë për gjeneratat e ardhshme. AIDSSH e ka mbështetur veprimtarinë e tij dhe vijimësinë e projekteve të ndërmarra në parimet e rëndësishme të kujtesës, duke e vënë kujtesën historike në themel të identitetit dhe trashëgimisë së individëve e shoqërive.

Plani vjetor i punës 2018, i cili është hartuar dhe miratuar duke u mbështetur në ligjin nr. 45/2015 dhe VKM nr. 98, datë 15.2.2017, ka përcaktuar drejtimit kryesorë të punës së AIDSSH për vitin 2018. Sipas këtij plani, veprimtaria e institucionit për vitin 2018, më së shumti do të ishte e fokusuar në disa shtylla kryesore: konsolidimi i arkivit të dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit, siguri i aksesit në dokumentet e ish-Sigurimit për të gjitha subjektet e përcaktuara në

ligj, rishqyrtimi historik i veprimtarisë së ish-Sigurimit të Shtetit, duke u mbështetur në kërkimin shkencor, të realizuar në bashkëpunim me institucionet kërkimore-shkencore në vend dhe institucione të tjera partnere, si dhe ndërtimi i një platforme komunikimi dhe dialogimi mbarëkombëtar, në funksion të edukimit qytetar, duke organizuar tryeza pune me grupe të ndryshme interesi, seminare, ekspozita dokumentare, konferenca shkencore ndërkombëtare, etj.

Kërkimi shkencor është mbështetur nga partnerët tanë dhe është materializuar në formën e botimeve serioze e platformave online të komunikimit, që kanë lehtësuar shkëmbimin e informacionit me të interesuarit dhe kanë rritur përgjegjësinë tonë. Secili prej projekteve të ndërmarra është realizuar në bashkëpunim me institucionet publike dhe organizata të tjera joqeveritare, duke synuar rezultate dhe impakt konkret në ridimensionimin e figurës së viktimave dhe ish-të persekutuarve të regjimit komunist, në përçimin e mesazheve që mbartin vlera edukative dhe emancipuese për shoqërinë, dhe fillimin e dialogut me qytetarët përta i përket të shkuarës komuniste në Shqipëri, në dimensionin tematik dhe gjeografik. "Dialogu lokal për diktaturën" nisi në Konispol e Tepelenë, për të vazhduar edhe me qytete të tjera për vitin 2019.

The background of the image is a close-up of aged, yellowish paper with handwritten text in a cursive script. The text is mostly illegible due to blurring, but some words like 'nyu', 'bēnto', 'jēō', and 'ma' are partially visible. The overall tone is warm and historical.

01

M E S A Z H I

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit u krijua në frymën e Rezolutës 1481 të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës “Domosdoshmëria për dënimin ndërkombëtar të krimeve të regjimeve totalitare komuniste”, (2006), Rezolutës nr.11 “Për dënimin e krimeve të kryera nga regjimi komunist në Shqipëri” (2006) dhe Rezolutës “Për dënimin e krimeve të komunizmit ndaj klerit, si dhe mirënjohjen e veçantë për rolin dhe veprimtarinë e klerikëve në mbrojtje të vlerave demokratike dhe të drejtave dhe lirive themelore të njeriut” (2016). të Kuvendit të Shqipërisë.

Sot, 80 vjet nga fillimi i Luftës së Dytë Botërore, 75 vjet nga çlirimi i vendit dhe 30 vjet pas rënies së komunizmit, AIDSSH e zhvillon veprimtarinë e vet në respekt të vlerave europiane e propeëndimore, “me vetëdije për historinë tonë, me përgjegjësi për të ardhmen... me vendosmërinë për... një shtet të së drejtës, demokratik e social,... me frymën e tolerancës... për mbrojtjen e dinjitetit dhe të personalitetit njerëzor, si dhe për prosperitetin e të gjithë kombit, për paqen, mirëqenien, kulturën dhe solidaritetin shoqëror...”, sipas Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

AIDSSH është në vitin e tretë të funksionimit, pas përpjekjesh dhe suksesesh të arritura ditë pas dite: 68 mbledhje dhe 482 vendime, 463 kandidatë apo zyrtarë të verifikuar, 184 kërkesa për qëllime rehabilitimi dhe dëmshpërblimi, 612 aplikime individuale, 172 kërkesa studimore dhe mediatike, 82.150 faqe të vëna në dispozicion në 2018.

Kërkesat kanë ardhur në rritje të konsiderueshme, po ashtu aktivitetet e institucionit pas vitit të parë të punës, vit i identifikimit të arkivave nga AIDSSH. Gjatë vitit të dytë arkivat u morën në dorëzim dhe në vitin të tretë, përparësia jonë do të jetë përpunimi i dokumentacionit arkivor të administruar. Ndërkohë, paralelisht me prioritetet, institucioni ka zhvilluar funksionet e veta, në përgjigje të kërkesave të qytetarëve, institucioneve,

grupeve të interesit, kërkuesve shkencorë dhe mediave kombëtare e të huaja.

Një strategji gjithëpërfshirëse komunikimi që është fokusuar te të përndjekurit, familjet e tyre dhe shoqatat e të drejtave të njeriut, të rinjtë dhe publiku i gjerë e ka zgjeruar ndjeshëm hartën e veprimtarisë së AIDSSH në 2018.

Institucioni e ka zhvilluar aktivitetin e vet jo vetëm në Tiranë, me vëmendje në datat përkujtimore e personalitetet historike, por ka lëvizur në të gjithë vendin, me bashkëpunime konkrete me komunitetet lokale, si në Shkodër, Tepelenë, Konispol, Pukë, Mirditë, Berat, Korçë e Gjirokastrë. Po ashtu, jashtë vendit, me marrëveshje bashkëpunimi apo shkëmbime përvojash, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Gjermani, Zvicër, Çeki, Poloni, Bullgari, Rumani, Izrael, duke arritur shumë individë, bashkësi dhe institucione të kujtesës.

Arkivi që zotëron AIDSSH ka vlerë historike, po aq sa operative. Si rezultat, puna jonë është organizuar në kuadër të së drejtës për njohje, informim, të kërkimit shkencor dhe edukimit qytetar, në partneritet me organizmat publike, homologe, institutet e studimeve akademike dhe institucionet e sigurisë kombëtare.

Mes sfidave të ardhshme mbetet plotësimi i strukturës së miratuar nga Kuvendi. Aktualisht, Autoriteti i kryen funksionet e veta me 50 % të stafit, fakt që na përball me radhë të gjata, rrit kohën e pritjes për marrje shërbimesh dhe ndikon proceset tona të përditshme të punës.

Me vizionin për të ofruar një platformë të besueshme për akses në trashëgiminë e madhe të dokumenteve të ish-Sigurimit, me angazhimin e qytetarëve shqiptarë të çdo fushe dhe institucioneve, duke funksionuar si burim vital që ndihmon në vlerësimin e së kaluarës së Shqipërisë në regjimin komunist, pas dy viteve veprimtari komplekse, Autoriteti e gjen veten më të organizuar, me përgjegjësi të shtuar dhe pritshmëri të mëdha në informimin e shoqërisë dhe hapjen e dialogut qytetar për të shkuarën.



02
K U A D R I
L I G J O R

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, si organ i lartë shtetëror, i pavarur, i ngarkuar për administrimin e procesit të informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, për realizimin e misionit të vet, udhëhiqet nga parimet e pajtimit dhe unitetit kombëtar, transparencës dhe bashkëpunimit midis institucioneve shtetërore.

AIDSSH organizohet dhe funksionon sipas rregullave të përcaktuara në ligjin nr. 45/2015, "Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë" dhe në rregulloren "Për Organizimin dhe Funksionimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit", miratuar me Vendimin e Autoritetit nr. 21, datë 09.05.2017. Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, Autoriteti ndihmohet nga Sekretariati Teknik, i cili vepron në përputhje me rregullat e përcaktuara në ligjin organik dhe aktet nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij. Rregulla të hollësishme për funksionimin dhe veprimtarinë e Sekretariatit Teknik janë përcaktuar në rregulloren e brendshme të Autoritetit.

Në organizimin dhe ushtrimin e funksioneve të veta, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit bazohet në aktet e mëposhtme ligjore dhe nënligjore:

Akte ligjore dhe nënligjore

- Ligji nr. 45, datë 30.04.2015, "Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë";
- Ligji nr. 8480, datë 27.5.1999 "Për Funksionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike",
- Ligji nr. 8457, datë 11.02.1999, "Për informacionin e klasifikuar "Sekret Shtetëror", i ndryshuar;
- Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003, "Për Arkivat"; dhe Normat Tekniko-Profesionale dhe Metodologjike të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë;
- Ligji Nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit

të drejtësisë".

- Ligji Nr. 12/2018, "Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Shërbimet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme".
- Ligji Nr. 23/2015, "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë" si dhe Vendimi Nr.816/2015, "Për miratimin e rregullores për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë".
- Ligji Nr.7514, datë 30.9.1991 "Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë", (i ndryshuar),
- Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për mbrojtje e të dhënave personale", i ndryshuar;
- Ligji Nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit";
- Ligji Nr. 152, datë 30.05.2013 "Për nëpunësin civil";

Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 98, datë 15.02.2017, "Për përcaktimin e procedurës së kalimit nën administrimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të materialeve arkivore që gjenden në Ministrinë e Mbrojtjes, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Shërbimin Informativ të Shtetit dhe në autoritete të tjera publike";

Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 935, datë 28.12.2016, "Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Mbrojtjes tek Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, të objektit nr. 52, me emërtim "Arkivi i Ri", brenda Territorit të Pronës nr. 12, me emërtimin "Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes", me vendndodhje lagjja nr. 10, Rruga e Dibrës, Tiranë dhe për një ndryshim në Vendimin nr. 515, datë 18.07.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes", i ndryshuar, me anë të së cilës është përcaktuar mjedisi në të cilin AIDSSH do të ushtrrojë veprimtarinë e vet;

Vendimi i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e tarifave dhe pagesave për shërbimet ndaj institucioneve apo personave që ofrohen nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”;

Akte rregullatore të brendshme të Autoritetit

Rregullore e brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e AIDSSH”, miratuar me Vendimin Nr. 21, datë 09.05.2017 të Autoritetit;

Rregullore për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike në AIDSSH, miratuar me Vendimin Nr. 13, datë 14.04.2017;

Rregullore për Mbrojtjen, Përpunimin, Ruajtjen dhe Sigurinë e të Dhënave Personale në AIDSSH, miratuar me Vendimin Nr. 25, datë 25/05/2017, të Autoritetit; Rregullore mbi publikimin e veprimtarisë së Autoritetit, në ushtrim të detyrave funksionale të ngarkuara me ligj, përmes buletinit në letër apo online në faqen e Autoritetit;

Vendimi i Kuvendit nr. 95, datë 22.12.2016, “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të institucionit të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”; Plani Strategjik dhe Plani i Veprimit të AIDSSH 2017-2020, miratuar me Vendimin Nr. 42, datë 22.06.2017, të Autoritetit;

“Kodi i sjelljes së mirë administrative” në Autoritetin për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”, miratuar me Vendimin Nr. 449, dt. 18.12.2018, të Autoritetit;

“Kodi i sjelljes” për Anëtarët e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”, miratuar me Vendimin Nr. 450, dt 18.12.2018.

Për vitin 2018 janë mbajtur 68 mbledhje të AIDSSH dhe janë marrë 482 vendime, nga të cilat 466 unanime, përkundrejt 68 vendimeve të marra në vitin 2017 .

03

**RESPEKTIMI DHE PLOTËSIMI I
DETYRIMEVE NDËRKOMBËTARE,
PËRMBUSHJA E REKOMANDIMEVE
TË “PROGRES RAPORTIT” TË BE-SË
PËR SHQIPËRINË NGA AIDSSH**

Krijimi i AIDSSH-së nga shteti shqiptar në vitin 2016 dhe hapja e trajtimi i dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit ishte në frymën e rezolutave ndërkombëtare që kanë trajtuar trashëgiminë e së shkuarës, si Rezoluta e Parlamentit Europian “Mbi ndërgjegjen europiane dhe totalitarizmin” (2009); Deklarata e Pragës “Mbi ndërgjegjen europiane dhe komunizimin” (2008); Rezoluta 1096 (1996) e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës “Masat për të çrrënjësuar trashëgiminë e sistemeve totalitare komuniste”, si dhe Rezoluta 1481 (2006) e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës “Domosdoshmëria për dënimin ndërkombëtar të krimeve të regjimeve totalitare komuniste”; të njohura nga Kuvendi i Shqipërisë, në vijim të të cilave janë miratuar Rezoluta nr.11 “Për dënimin e krimeve të kryera nga regjimi komunist në Shqipëri” (2006) dhe Rezoluta “Për dënimin e krimeve të komunizmit ndaj klerit, si dhe mirënjohjen e veçantë për rolin dhe veprimtarinë e klerikëve në mbrojtje të vlerave demokratike dhe të drejtave dhe lirive themelore të njeriut” (2016).

Shqipëria është angazhuar për forcimin e sistemit të drejtësisë dhe të drejtave të njeriut, nëpërmjet ratifikimit të traktateve ndërkombëtare e rajonale dhe përfshirjes së saj në Programin e Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara 2030. Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Qytetare dhe Civile dhe Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut njohin barazinë përpara ligjit dhe elementë të tjerë kyç që forcojnë sistemin e drejtësisë. Objektiv 16 i zhvillimit të qëndrueshëm të Programit të Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara synon shoqëri që jetojnë në paqe dhe gjithëpërfshirëse, akses në drejtësi dhe institucione efektive e të besueshme, si elementë thelbësorë për zhvillimin. Më tej, Kombet e Bashkuara për Shqipërinë pohojnë se forcimi i ligjit, nëpërmjet rritjes së kapaciteteve në institucionet e drejtësisë dhe përmirësimit të proceseve të drejtësisë tranzicionale, ndihmon sigurimin e së vërtetës, e ridimensionon atë dhe u jep zë viktimave, elemente që vënë themelet për zhvillim të qëndrueshëm dhe paqe në shoqëri. Në këtë kuadër, gjatë vitit 2018, AIDSSH ka zbatuar programin

“Përkujtojmë për të shëruar dhe parandaluar”, të fokusuar në zhvillime konkrete sa i takon trajtimin të trashëgimisë së të shkuarës dhe konsolidimit të demokracisë.

Në Raportin e Progresit 2018 të Komisionit Europian për Shqipërinë vihet theksi në monitorimin e proceseve të bëra nga Shqipëria sa i takon zbatimin të reformës në drejtësi, 5 prioritetet kyçe, në veçanti vlerësimi i figurës së gjyqtarëve dhe prokurorëve (vettingu).

Sipas raportit, Shqipërisë i është kërkuar të rrisë masat për të përforcuar pavarësinë, eficiencën dhe llogaridhënien e institucioneve të drejtësisë, për të cilat po zbatohet reforma përkatëse, duke rritur paanshmërinë dhe transparencën e institucioneve të drejtësisë, gjyqësorit, prokurorisë dhe organeve të larta drejtuese. Dokumentet strategjike ndërsektoriale të drejtësisë për 2017-2020 dhe plani i veprimit u vunë në zbatim që në nëntor 2016.

Në këtë kuadër, AIDSSH ka detyrimin ligjor të verifikimit të pastërtisë së figurave të zyrtarëve të lartë, të cilët i janë nënshtruar procesit gjatë vitit 2018. Procesi i vërtetimit të pastërtisë së figurës përfshin shumë institucione dhe synon rritjen e profesionalizmit në të gjitha sferat, konsolidimin e pavarësisë e paanësisë dhe rikthimin e besimit të publikut tek institucionet. Po në raportin e KE për 2018, Shqipërisë i është kërkuar të ndërmarrë masa efektive për të përforcuar mbrojtjen e të drejtave të njeriut, - korniza ligjore është ndërtuar në linjë me standardet europiane, - sipas të cilave, vendi ynë ka ratifikuar shumë konventa ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

Në prioritetin e pestë, Të Drejtat e Njeriut, në dokumentin e Komisionit Europian të datës 17.04.2018, “Albania 2018 Report”, faqe 26, ka një rekomandim për Autoritetin për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit” që thotë:

“Sa i përket të drejtës për jetën, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit



Përfaqësimi i AIDSSH-së në raportimin për Zhdukjet me Forcë në Gjenevë, në kuadër të Konventës së OKB-së

pas krijimit të tij në qershor të vitit 2017, miratoi një strategji. Pas një vizite në vend në dhjetor të vitit 2016, Grupi i Punës i OKB-së për personat e zhdukur në mënyrë të detyruar apo vullnetare (WGEID) la disa rekomandime për Shqipërinë, për të trajtuar krimet e kryera gjatë periudhës së diktaturës komuniste. Për shembull, WGEID rekomandoi që Shqipëria të njohë zhdukjet e detyruara të së kaluarës dhe të garantojë mospërsëritjen e tyre, duke gjetur një sistem të përshtatshëm. Gjithashtu, kërkoi krijimin e një sistemi që ka qasje gjithëpërfshirëse, në vend të masave të copëzuara, për të shuar gjithë paragjykimet që rezultojnë nga represioni i kaluar politik. Numri i njerëzve që janë rrëmbyer ose burgosur fshehurazi gjatë diktaturës mbetet i panjohur, por vlerësohet të jenë rreth 6 000 persona të zhdukur”.

Përsa i përket këtij rekomandimi dhe duke u bazuar në detyrat funksionale që i ngarkon ligji 45/2015, AIDSSH është angazhuar aktivisht dhe ka bashkëpunuar me Komisionin Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP) dhe institucionet e tjera publike në vend për personat e humbur, Institutin i Integritetit të të Përndjekurve Politikë dhe vijon të japë kontributin e vet konkret në sigurimin e informacionit dokumentar



Prezantimi i aplikacioneve për të zhdukurit në AIDSSH

të lidhur me ta, po ashtu, në ngritjen e çështjes dhe lobimin me institucione publike e ndërkombëtare për avancim të kërkimeve.

AIDSSH ka bashkëpunuar me Prokurorinë për fillimin e procedurës së gjetjes dhe identifikimit të vendvarrimeve të personave të zhdukur në diktaturë, si dhe me qeverisjen lokale, duke paraqitur propozime konkrete për vendet e kujtesës.

AIDSSH ka bërë kërkesë pranë Ministrisë përgjegjëse për përfshirje në projektligjin “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë” të një pike ku të përfshihen si vende kujtese dhe vetëdijësimi, vendet e pushkatimit dhe vendvarrimet e fshehta të periudhës së diktaturës komuniste. Konkretisht, nismat për kthimin në vend kujtese:

-të Kampit të Tepelenës (1949-1951), bazuar në Urdhrin nr. 45, datë 6. 6. 2017 për “Ngritjen e grupit të punës për kërkimin e dokumentacionit arkivor për Kampin e Tepelenës dhe krijimin e një memoriali për përkujtimin e datës 30 gusht si Dita Ndërkombëtare e të Zhdukurve”.

-dhe të Mënikut (në Pezë), ku u zvarrosën eshtrat

e 22 intelektualëve të pushkatuar pa gjyq më 26 shkurt 1951, vendvarrim masiv i shumë të dënuarve nga diktatura, bazuar në propozimin e Autoritetit për këshillin bashkiak të Tiranës, për kthimin në vend të ndërgjegjes. Në të dy rastet dhe në të tjera që institucioni po trajton, është ndërtuar partneritet me institucionet publike, qendrore dhe lokale, shoqërinë civile dhe familjarët, për ta kthyer vëmendjen te çështja e të zhdukurve dhe e drejta njerëzore për të vërtetën. Më 4 qershor 2018, Komiteti i ekspertëve të OKB-së miratoi dhe publikoi vërejtjet përmbyllëse, pasi shqyrtoi Raportin e Shqipërisë mbi zbatimin e Konventës së OKB-së "Për mbrojtjen e të gjithë personave nga Zhdukjet me Forcë", ku vendi ka aderuar që në vitin 2007 dhe është angazhuar në përmirësimin e kuadrit ligjor për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, përfshirë zhdukjet me forcë. Në raportimin në Gjenevë u ftua të merrte pjesë AIDSSH, mes institucioneve të tjera të pranishme publike.

Zhdukjet me Forcë u parashikuan si vepër penale me ndryshimet në Kodin Penal të miratuara në vitin 2013. Gjatë raportimit u evidentua se janë ndërmarrë një sërë masash për përmirësimin e kuadrit ligjor në përputhje me Konventën, dhe përfaqësuesit e institucioneve informuan mbi masat e ndërmarra për të garantuar mbrojtjen e të drejtave të njeriut, veçanërisht të personave të privuar nga liria, të drejtën e viktimës për të njohur të vërtetën, pasojat e zhdukjes me forcë, sigurimin e drejtësisë, hetimin e rasteve dhe sjelljen e shkelësve para drejtësisë, mjetet efektive, kompensimin dhe ruajtjen e memories historike për zhdukjet me forcë të ndodhura gjatë periudhës së komunizmit.

Historikisht, Shqipëria ka pësuar shumë nga ky krim, ku gjatë regjimit komunist një numër i konsiderueshëm qytetarësh janë ekzekutuar, ndërsa të tjerët u zhdukën në rrethana të panjohura. Ndaj Shqipëria ka ndërmarrë masa konkrete me hartimin e marrëveshjes së bashkëpunimit me Komisionin Ndërkombëtar për Persona të Zhdukur.

Në funksion të këtij bashkëpunimi, më datë 30 gusht 2018, me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Personave të Zhdukur, është bërë prezantimi bashkërisht me ICMP-në i dy aplikacioneve online që do të ndihmojnë procesin e gjetjes dhe identifikimit të personave të zhdukur gjatë diktaturës komuniste në Shqipëri. Këto aplikacione ndihmojnë familjarët e personave të zhdukur të raportojnë rastet, si dhe të marrin informacion në lidhje me statusin e rasteve individuale të personave të zhdukur. Treguesi i vendvarrezave i mundëson përdoruesve që në mënyrë anonime të japin informacion mbi vendndodhjen e varrezave ku mund të gjenden mbetjet njerëzore të personave të zhdukur. Aplikacionet janë publikuar dhe vendosur në faqen zyrtare në AIDSSH-së, për të gjithë të interesuarit.

Gjatë vitit 2018, në adresë të AIDSSH-së janë paraqitur 57 kërkesa me objekt rehabilitimin dhe qartësimin e fatit të vdekurve apo të të zhdukurve. Rezulton se 35 kërkesa janë përfunduar me vendimmarrje të Autoritetit dhe janë në proces verifikimi 22 kërkesa.

I gjithë kuadri i mësipërm ligjor dhe veprimtaria e deritanishme e AIDSSH-së është në funksion të mbajtjes gjallë të kujtesës mbi të shkuarën, sepse "nuk mund të ketë të vërtetë pa përkujtimin", që e shkuara të mos përsëritet dhe shoqëria të ushtrojë të drejtën e vet për t'u njohur me të vërtetën.

04

**ZBATIMI I REZOLUTËS SË
KUVENDIT PËR VLERËSIMIN
E VEPRIMTARINË SË AIDSSH
PËR VITIN 2017**

Rezoluta e Kuvendit, datë 28.6.2018, "Për vlerësimin e veprimtarisë së AIDSSH-së për vitin 2017", në vijim të vlerësimit të veprimtarisë së ushtruar nga AIDSSH gjatë vitit 2017, ka renditur disa detyra dhe rekomandime të cilat duhej të përmbusheshin nga ana e AIDSSH-së gjatë vitit 2018, konkretisht:

Përfundimin e procedurave për kalimin në administrim të Autoritetit të të gjithë dokumentacionit arkivor të ish-Sigurimit të Shtetit, nga arkivat e autoriteteve publike që i kanë në administrim aktualisht

Në përmbushje të kësaj detyre, gjatë vitit 2018, grupi i punës i ngarkuar me detyrën e marrjes në dorëzim, ka vijuar punën me marrjen në dorëzim të dokumenteve arkivore kryesisht nga Arkivi i Sistemit të Ministrisë së Brendshme, duke qenë se aty ndodhet pjesa më e madhe e dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit.

Gjatë vitit 2018 janë marrë në dorëzim dokumentet që u përkasin 4 fondeve arkivore: Drejtoria e Parë, Drejtoria e Dytë, Drejtoria e Tretë dhe Fondi 141, me një total prej 12.547 dosjesh¹.

Ky proces është realizuar duke respektuar procedurat e përcaktuara në Ligjin Nr. 9154, datë 6.11.2003 "Për Arkivat" dhe Normat Tekniko-Profesionale dhe Metodologjike të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë verifikimin dosje më dosje dhe fletë për fletë të dokumenteve, duke bërë ballafaqimin me inventarët e dosjeve të fondeve arkivore dhe plotësimin e procesverbaleve përkatëse të marrjes në dorëzim. Gjatë procesit të marrjes në dorëzim është kryer edhe verifikimi i gjendjes fizike të dokumenteve, ku deri tani ka rezultuar se dokumentet nuk kanë dëmtime të dukshme.

Përveç procesit të inventarizimit të hollësishëm dhe marrjes në dorëzim të dokumenteve arkivore, puna

¹ Të dhëna më të detajuara janë dhënë në seksionet më poshtë.

ka vijuar edhe me identifikimin e dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit, jo vetëm me Arkivin e Sistemit të Ministrisë së Brendshme, por edhe me institucione të tjera arkivore, konkretisht, Arkivin Shtetëtor të Sistemit Gjyqësor, Arkivin Qendror të Forcave të Armatosura, Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave, Prokurorinë e Përgjithshme dhe Prokuroritë pranë gjykatave në rrethe.

Edhe pse nga ana e Autoritetit u rishikuan vendimet për marrjen në dorëzim të dokumenteve dhe u angazhua i gjithë stafi i drejtorisë së arkivit, kjo detyrë është ende në proces, sepse volumi i dokumenteve është shumë i madh dhe burimet njerëzore të angazhuara nuk ishin të mjaftueshme; është punuar me 50% të stafit të drejtorisë së arkivit, në kushte ekstremisht të vështira të punës në Arkivin e Sistemit të Ministrisë së Brendshme, pa ajrim, pa ngrohje, ndriçim, etj, si dhe në largësi të konsiderueshme nga mjedisi ku ushtron veprimtarinë funksionale AIDSSH. Procesi vazhdon edhe për 6-mujorin e parë të vitit 2019.

Vlen të theksohet se AIDSSH ka trajtuar me prioritet procesin e kërkimit të verifikimit të zyrtarëve/kandidatëve para emërimit apo ngritjes në detyrë, sipas objektivit të kërkesave të paraqitura nga institucionet kushtetuese apo autoritetet publike.

Përmirësimi i procedurave të ndjekura për verifikim nga Autoriteti, sipas standardeve dhe eksperiencave më të mira të institucioneve homologe në ish-kampin socialist të Europës Lindore, me qëllim trajtimin me transparencë, objektivitet dhe profesionalizëm të kërkesave të qytetarëve.

Autoriteti ka punuar sistematikisht duke diskutuar në mënyrë permanente, brenda strukturave të veta, mbështetur në frymën e legjislationit, për ta bërë këtë proces cilësor, transparent e lehtësisht të kuptueshëm si dhe për të nxjerrë një produkt cilësor në ndihmë të subjekteve të interesuara. Konkretisht:

Janë bërë ndryshimet konkrete në formularët e aplikimit të kërkesave institucionale dhe në ndjekjen e procedurave të kërkesave individuale, duke pasur parasysh standardet dhe eksperiencat më të mira të institucioneve homologe (bullgare, çeke, gjermane e rumune), me qëllim trajtimin me transparencë, objektivitet dhe profesionalizëm të kërkesave të qytetarëve, të cilat janë miratuar nga ana e Autoritetit. Është rishikuar i gjithë procesi i trajtimit të aplikimeve për studiues, media dhe është krijuar një skemë orientuese për ndjekjen e të gjitha fazave të trajtimit të një praktike nga studiues, media.

Janë krijuar regjistra elektronikë të dokumenteve të digjitalizuar dhe ofrimi i aksesit të të gjithë dokumenteve të digjitalizuara realizohet brenda një kohe shumë të shkurtër.

Është krijuar baza e të dhënave të kërkesave të trajtuara nga AIDSSH, e cila përmban të dhëna të detajuara në lidhje me trajtimin e kërkesave, nga regjistrimi, deri dhënien e dokumenteve kërkuarve.

Janë hartuar dhe miratuar disa akte të brendshme, të cilat ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në përmirësimin e procedurave të ndjekura për verifikim, konkretisht janë miratuar: Vendimi nr. 43, dt. 13.02.2018 “Për ngritjen e Komisionit për inventarizimin, përpunimin, hartimin e listës me bazë të dhënash të dokumentacionit arkivor”; Vendimi nr. 173, dt 05.06.2018, “Për standardizimin e komunikimit me subjektet e interesuara që kërkojnë informacion mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit pranë AIDSSH”; Vendimi nr. 449, dt. 18.12.2018, Miratimi i “Kodit të sjelljes së mirë administrative” për punonjësit e Autoritetit; Vendimi nr. 450, dt. 18.12.2018, Miratimi i “Kodit të Sjelljes së Anëtarëve” për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”.

Janë informuar agjencitë qeveritare, institucionet publike, partitë politike dhe çdo institucion tjetër që ka detyrimin ligjor apo dëshirë për të bashkëpunuar

me Autoritetin, për të sqaruar procesin e verifikimit të pastërtisë së figurës së zyrtarëve/kandidatëve para emërimit apo ngritjes në detyrë (njohjen me formën dhe përmbajtjen e formularit tip për t’u plotësuar nga vetë subjekti verifikues), dhe për ta përcaktuar atë si normë për dy vitet e ardhshme, në mënyrë që të jetë sa më transparent dhe brenda afateve të përcaktuara në ligj, me qëllim që ky proces të mos keqpërdoret apo të përdoret më tej nga ndonjë forcë politike, agjenci, grupim apo individ.

Janë kryer fushata ndërgjegjësuere dhe sensibilizuese me qytetarët, përfshirë studiuesit dhe mediat, ku në mjaft raste ata janë bërë palë bashkëpunuese në njohjen me procedurat ku kalon procesi i informimit dhe dhënia e dokumentacionit të administruar nga ana jonë, sipas objektit të kërkesës. Ky informacion dhe këto fushata nuk janë zhvilluar të izoluara, vetëm brenda qytetit të Tiranës, por janë shtrirë gjeografikisht në disa qytete të Shqipërisë dhe kanë përfshirë grupmosha të ndryshme.

Janë marrë të gjitha masat për sa i përket zbatimit të kërkesave të sigurisë në fushën e sigurimit të informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror” që trajtohet në sistemet e komunikimit dhe informacionit, sipas rekomandimeve të DSIK.

Forcimi i kapaciteteve administrative, sigurimi i infrastrukturës së nevojshme për studiuesit, me fokus të veçantë krijimin e një arkivi digjital të integruar, me qëllim aksesin sa më të gjerë për subjektet e interesuara në dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit

Për forcimin e kapaciteteve administrative, AIDSSH ka punuar në disa drejtime. Këta përfshijnë së pari, plotësimin e vendeve vakante për pozicionet e punës të miratuara nga Qeveria, rritjen e nivelit të përgatitjes profesionale të punonjësve, duke marrë pjesë në trajnime profesionale dhe cilësore të zhvilluara nga ASPA dhe DSIK, organizimin e aktiviteteve të



Nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit dhe Institutit të Historisë “Ali Hadri” Prishtinë

ndryshme, sigurimin e asistencës me ekspertë të fushave të ndryshme (historianë, arkivistë, etj), e të tjera. Së dyti, është punuar në përmirësimin e infrastrukturës teknologjike për digjitalizimin dhe ruajtjen e dokumenteve, në krijimin e mjeteve të reja të kërkimit, në sigurimin e pajisjeve mobiluese të zyrave, në sigurimin e fondeve dhe kryerjen e procedurave të tenderimit për rikonstruksionin e katit të parë të godinës së dhënë nga Qeveria, rritjen e bashkëpunimit me institucionet publike dhe partnerët e huaj për sigurimin dhe financimin e AIDSSH-së, në mënyrë të veçantë për përfundimin e rikonstruksionit të godinës (kati I dhe kati II) dhe kompletimin e saj me pajisjet e arkivit, në organizimin e aktiviteteve të ndryshme.

Pas dakordësimit në parim me Ambasadën Suedeze në Shqipëri, stafi i AIDSSH-së ka punuar intensivisht për hartimin e projektpropozimit “Rikonstruksioni i godinës së AIDSSH-së dhe shërbimeve ICT për krijimin e një arkivi modern”. Si pjesë e këtij projekti janë parashikuar përfundimi i rikonstruksionit të godinës së dhënë nga Qeveria, si dhe pajisjet hardware (server + datastorages, etj.) dhe sistemi i arkivit të integruar digjital.

Për shërbimin e ofruar për studiues/media janë përfshirë burime njerëzore, ndonëse të limituara në numër, për arsye që tashmë dihen. Është krijuar mundësia e krijimit të këndit për studiuesit. Studiuesit kanë mundësi të konsultojnë dhe të njihen me mjetet



Nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit dhe Muzeut Kombëtar “Gjethi”

e kërkimit dhe dokumentet arkivore, qofshin këta në formë origjinale apo të mikrofilmuara, sipas kërkesave të paraqitura nga ana e tyre.

Rritja e bashkëpunimit dhe bashkërendimit të punës me institucionet dhe autoritetet publike e donatorët, si dhe me organizatat homologe.

Përgjatë vitit 2018, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit ka vijuar bashkëpunimin me të gjitha institucionet partnere me të cilët ka pasur komunikim dhe ka nënshkruar marrëveshje gjatë vitit 2017 dhe njëkohësisht, ka punuar intensivisht për zgjerimin e këtij bashkëpunimi me institucione të tjera të reja homologe.

Ky bashkëpunim ka konsistuar në lidhjen e marrëveshjeve të reja të bashkëpunimit me institucionet homologe, në kuadër të bashkëpunimit dhe bashkërendimit të aktiviteteve mbi kujtesën dhe organizimin e veprimtarive të përbashkëta. Në këtë kuadër janë nënshkruar dy marrëveshje të reja bashkëpunimi, Marrëveshja e Bashkëpunimit për realizim të aktiviteteve të përbashkëta me Muzeun “Gjethi”, Marrëveshja e Bashkëpunimit me Institutin e Historisë “Ali Hadri”, Prishtinë, për projekte të përbashkëta kërkimore-shkencore mes Shqipërisë dhe Kosovës sa i takon komunizmit, dhe është bashkërenduar puna për konferencën ndërkombëtare

shkencore për internim-dëbimet e projekte të tjera.

Marrëveshjet e mëparshme me Institutin e Historisë në Akademinë e Studimeve Albanologjike, institucionet publike të kujtesës ISKK dhe IIPP kanë shërbyer për të bashkërenduar punët në organizimin e aktiviteteve sipas kalendarit të kujtesës për të gjitha veprimtaritë vjetore.

Përveç bashkëpunimit me institucionet të mësipërme, gjatë 2018 AIDSSH ka bashkëpunuar edhe me donatorë si PNUD në Shqipëri dhe Ambasada e Italisë, duke vënë në jetë projektin “Përkujtojmë për të shëruar dhe parandaluar”. Projekti u zbatua në disa drejtime:

- Dëshmitë gojore, programi “Edhe muret kanë veshë”, me mbledhjen e dëshmimeve gojore të mbijetuarve të komunizmit në të gjithë Shqipërinë; instalacioni artistik “Edhe muret kanë veshë”, i shfaqur në 6 qytete të vendit, në prag të Ditës së Europës; krijimi i platformës online të dëshmimeve me të njëjtin emër e i një arkivi digjital, publikimi i tyre në rrjet për të gjithë të interesuarit e kërkuesit shkencorë dhe dokumentari që rrëfen këtë rrugëtim të dëshmimeve.
- Kërkimi shkencor, i kryer në dosjet e periudhës 1944-1991 për dëbim-internimet, për konceptualizimin e historisë dhe praktikave të punës së detyruar gjatë regjimit komunist, përmes një qasjeje historiko – juridike ndaj institucionalizimit të punës së detyruar. Kjo punë u finalizua në konferencën e parë ndërkombëtare shkencore mbi internim-dëbimet të 29-31 tetorit 2018, botimin në dy gjuhë të kornizës juridike-historike dhe përgatitjen për botim të studimeve mbi “Kënetën e Maliqit” dhe figurën e Sabiha Kasimatit.
- Kërkimet e mësipërme kontribuojnë në konceptimin e vendeve të kujtesës si Kampi i Tepelenës, për të cilin AIDSSH vijon punën përkujtoimore dhe ritjen e ndërjegjësimit të shoqërisë, me hapat e ndërmarrë për ta kthyer në zonë të mbrojtur, lejen për ngritjen e memorialit në përkujtim të jetëve të fëmijëve të humbur, botimin e librit me dëshmitë e

të mbijetuarve të kampit të Tepelenës.

- Pasurimi me informacionet e sakta në gjuhën shqipe për ngjarje historike dhe personalitete të përndjekura në Wikepedian shqip, në bashkëpunim me studiuesit dhe të rinjtë e interesuar. Projekti u përmbyll në dhjetor 2018.

Projekti tjetër i ndërmarrë nga AIDSSH në bashkëpunim me donatorët përgjatë vitit 2018, është “Roli i shkencës në zhvillimin e shoqërisë gjatë viteve të para të vendosjes së regjimit komunist (1945-1954)”. AIDSSH dhe PERFORM – Shkenca Sociale Aktive dhe të Përgjegjshme, Qeveria e Zvicrës, mbështetën hulumtimin dhe ndërtimin e një narrative mbi rolin e shkencës, elitave intelektuale dhe kërkimit shkencor në vitet e para të vendosjes së regjimit komunist në Shqipëri.

Nisma synoi një analizë të thellë të elitave intelektuale në vitet 1945-1954, si dhe të ndikimit që ato, shkenca dhe kërkimi shkencor, kishin në procesin e vendimmarrjes, duke nxitur reflektimin e shoqërisë mbi rëndësinë e shkencës në proceset tranzitore të vendit. Puna kërkimore arkivore u gërshetua me informimin e publikut dhe ruajtjen e kujtesës historike, për nisjen e një dialogu publik mbi këtë temë.

Gjatë 2018 ka vijuar bashkëpunimi me Prezencën e OSBE-së në Shqipëri. Në fokus të këtij bashkëpunimi ka qenë ndihma dhe mbështetja e AIDSSH-së në ndërtimin e një arkivi modern, në përputhje me standardet ndërkombëtare, nëpërmjet asistencës me ekspertë të huaj dhe ngritjes e përgatitjes profesionale të stafit të AIDSSH-së, duke mundësuar shkëmbimin e përvojës me institucionet homologe në Gjermani dhe Çeki.

Realizimi e objektivave, në kuadër të Planit Strategjik 2017-2020, për të përmbushur detyrat që përcakton ligji nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të

Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”

Plani Strategjik 2017-2020, si dokumenti më i rëndësishëm strategjik i AIDSSH-së, ka shërbyer si maket mbi të cilin është hartuar plani i punës së AIDSSH-së për vitin 2018. Në planin e punës 2018, secili prej objektivave strategjikë të AIDSSH-së është zbërthyer në plan veprimi për secilën nga drejtoritë dhe sektorët përkatës. Zbatimi i secilit prej këtyre objektivave është pasqyruar në seksionin Veprimtaria e AIDSSH-së, të paraqitur më poshtë.

Ndërtimi i një strategjie komunikimi, me qëllim informimin e qytetarëve dhe të rinjve në veçanti, nëpërmjet kumtesave në ditët kalendarike



që u përkushtohen ngjarjeve tronditëse të ndodhura mbi viktima të pafajshme të diktaturës komuniste, mbi bazën e provave dhe fakteve të pakontestueshme, të bëra publike për herë të parë dhe të marra në mënyrë autentike nga dosjet e krijuara nga struktura të ish-Sigurimit të Shtetit.

AIDSSH ka përgatitur një platformë komunikimi në mbështetje të Planit Strategjik. Ajo ka frymëzuar planet vjetore dhe çdo komunikim me publikun, si dhe kërkesat e institucionit për rritje fondesh, qoftë në Qeveri, qoftë me donatorë.

Komunikimi me publikun dhe qytetarët është kryer në mënyrë të vazhdueshme përgjatë gjithë vitit 2018, duke e konkretizuar me organizimin e aktiviteteve të natyrave



të ndryshme, të fokusuar në data përkujtimore, në personalitete të mbijetesës së dinjitetit njerëzor e rezistencës dhe dialogut lokal në komunitet. Përparësi është treguar ndaj të përndjekurve dhe familjeve të tyre, brenda e jashtë vendit.

Në bashkëpunimin me Shoqatën e Mësuesve të Historisë, partnerët dhe institucionet homologe, shoqatat përkatëse të të drejtave të njeriut, familjarët dhe komunitetin, Autoriteti ka arritur të ketë përfshirje të gjerë të të rinjve, studiuesve dhe mediave në çdo aktivitet, në qytete të ndryshme të vendit.

Rëndësi i është dhënë mënyrës së transmetimit të informacionit përmes mjeteve divulgative të nivelit të lartë në paraqitje, komunikim të mesazhit dhe aftësie ndërveprimi me të interesuarit. Nisur që nga posterët, faqet online, librat dhe publikimet e tjera, koncepti i videove të prodhuara, për të dhënë informacion të saktë e në të njëjtën kohë, për të qenë tërheqës për të rinjtë.



Në përgjigje të rezolutës së Kuvendit dhe duke u mbështetur në përvojën e deritanishme, Autoriteti ka punuar për ndërtimin e një draftstrategjie komunikimi, i cila mbështetet në disa shtylla kryesore: identifikimin dhe përcaktimin e grupeve e synuara për t'u arritur sipas kalendarit e kujtesës, kërkimin shkencor për rishqyrtimin e historisë dhe edukimin qytetar.

Si pjesë e kësaj strategjie janë parashikuar ekspozita dokumentare, studime shkencore, konferenca shkencore, botime, seminare, workshop-e,

takime bashkëbiseduese për tema konkrete, duke bashkëpunuar me të gjithë aktorët e fushës. Në aktivitete është menduar paraqitja e materialeve dokumentare, informimi mbi dosjet, ngjarjen/figurën përkatëse dhe krijimi i kontekstit historik, social e politik të kohës, duke u përqendruar në grupe të ndryshme shoqërore.

Mbërritja te grupet e interesit

AIDSSH ka vepruar gjatë vitit 2018 me një strategji të hapur komunikimi, me qëllim informimin e qytetarëve dhe gjeneratës së re. Për mundësimin e aktivitetit ndërgjegjësues të AIDSSH-së është rishikuar kalendarit i kujtesës dhe aktivitetet e parashikuara për vitin 2018; Janë angazhuar grupet e interesit në aktivitetet me fokus ndërgjegjësimin dhe edukimin qytetar;

Është bërë e mundur përfshirja e sa më shumë të rinjve në të gjithë vendin në aktivitetet me temë rishikimin e historisë dhe vënien në vend të dinjitetit njerëzor të personave që e vuajtën regjimin totalitar, në bashkëpunim me Shoqatën e Mësuesve të Historisë dhe shoqata rinore;

- Janë në dispozicion të studiuesve dhe medias, konform ligjit 45/2015, neni 36 e në vazhdim, dokumente të administruara nga AIDSSH, për trajtimin dhe studimin në thellësi të ngjarjeve historike.
- Të gjitha aktivitetet janë bërë publike me informacionin prezantues në rrjete sociale dhe ftesa elektronike sipas eventeve përkatëse.
- Është vënë fokusi në detaje të ekspozitës/botimit, dhe trajtimi më i thelluar i tyre: në intervista, shkrime, artikuj, kronika të posaçme.
- Janë bërë publikime në faqen ueb të Autoritetit ose në faqet e tjera të AIDSSH, të lidhura me ngjarjen.
- Është bërë përkujtimi i ngjarjes/figurës historike, duke sjellë në dritë elemente të dosjes përkatëse, si dhe duke afruar të rinjtë me burimet e AIDSSH.



- Janë mbështetur me dokumentacion gazetarët dhe të interesuarit për trajtimin e materialeve të Autoritetit.
- Janë mbështetur me dokumentacion studiuesit për kërkimin e vazhdueshëm shkencor për figura/

ngjarje historike.

- Janë harmonizuar elementët e mësipërm, për të ndërgjegjësuar në mënyrë të vazhdueshme publikun me informacion të qenësishëm, me anë të aktiviteteve të mirëmenduara, sipas kalendarit dhe projekteve të kujtesës të AIDSSH-së.

Krijimi i bazës së të dhënave me emrat e subjekteve të verifikuara, informacionet për strukturat operative ose bashkëpunëtorët e ish-Sigurimit të Shtetit, që janë verifikuar dhe analizuar nga komisioni, i cili ka funksionuar në bazë të ligjit nr. 8043, datë 30.11.1995, “Për kontrollin e figurës së zyrtarëve dhe personave të tjerë që lidhen me mbrojtjen e shtetit demokratik” dhe atyre që janë verifikuar dhe analizuar nga AIDSSH.

Realizimi i këtij procesi ka filluar që në fillim të vitit 2018. Në shkurt 2018 është miratuar Urdhri nr. 5, datë 19.02.2018, “Për inventarizimin, përpunimin, hartimin e listës me bazë të dhënash të dokumentacionit të administruar sipas Ligjit nr. 8001 datë 22.9.1995 “Për gjenocidin dhe krimet kundër njerëzimit kryer në Shqipëri gjatë sundimit komunist për motive politike, ideologjike dhe fetare” si dhe ligjit nr. 8043 datë 30.11.1995 “Për kontrollin e figurës së zyrtarëve dhe personave të tjerë që lidhen me mbrojtjen e shtetit demokratik”.

Në zbatim të urdhrit të mësipërm janë tërhequr fizikisht dokumentet e fondeve arkivore, Komisioni “Mezini” dhe Komisioni “Bezhani”. Pas kontrollit që iu bë dosjeve, është konstatuar që dokumentet ishin praktika të këtyre komisioneve, sipas kërkesave që ata kishin bërë në institucionet përkatëse MPB, SHISH, DPA, MM për verifikimin e figurave të zyrtarëve që kandidonin dhe subjekteve politike që ata përfaqësonin.

Ka përfunduar verifikimi/kontrolli i dosjeve dhe inventarizimi i dokumentacionit që u gjet në fondet Komisioni “Mezini” dhe Komisioni “Bezhani”. Inventarizimi është bazuar në titujt e dosjeve. Është krijuar një tabelë elektronike me të dhënat e gjetura në dokumentet përkatëse, ku rezulton se deri më tani janë hedhur **4651** rekorde me të dhëna nga dokumentet që i përkasin fondit Komisioni “Mezini” dhe **730** rekorde me të dhëna nga dokumentet që i përkasin fondit Komisioni “Bezhani”.

Identifikimi dhe analizimi i dokumenteve që mund të deklasifikohen, me qëllim bërjen publike për individët dhe studiuesit vendas e të huaj.

Procedura e deklasifikimit të dokumenteve arkivore të klasifikuara (dosje formulare, dosje përpunimi, dosje personale apo dosje të punës të krijuara nga struktura të ish-Sigurimit të Shtetit), fillon dhe zhvillohet rast pas rasti, mbi bazën e kërkesave individuale, institucionale apo studimore për informim mbi dokumentet e ish-Sigurimit.

Baza ligjore ku mbështetet zhvillimi i procedurave përkatëse në këtë drejtim janë dispozitat e ligjit nr. 8457, datë 11.02.1999, “Për informacionin e klasifikuar “Sekret Shtetëror”, i ndryshuar, VKM nr. 123, datë 15.03.2018 “Për rregullat e procesit të klasifikimit të sekretit shtetëror”, i ndryshuar, VKM nr. 124, “Për deklasifikimin e zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, që ndodhet në rrjetin kombëtar të arkivave”,

Urdhri nr. 68, “Për miratimin e listës së dokumenteve të klasifikuara “Sekret Shtetëror” në AIDSSH”, i ndryshuar, Urdhri nr. 13, datë 03.05.2018, “Për krijimin e komisionit të deklasifikimit dhe zhvlerësimin të informacionit të klasifikuar “Sekret Shtetëror” në AIDSSH”.

Gjatë vitit 2018, AIDSSH ka marrë të gjitha masat që krahas proceseve të tjera të punës të kryejë identifikimin dhe përgatitjen e procedurave për deklasifikim të të gjitha dokumenteve të kërkuara nga qytetarët, institucionet, studiuesit apo përfaqësuesit e medias. Gjatë vitit 2018 janë deklasifikuar plotësisht dhe janë vënë në dispozicion të kërkuësve 33.700 fletë dokumente arkivore.


05

**VEPRIMTARIA E AIDSSH-SË
PËR VITIN 2018**

5.1 Aktiviteti i institucionit

Bazuar në Planin Strategjik 2017-2020, me Vendim nr. 28, datë 26.1.2018, Autoriteti ka miratuar “Planin vjetor të punës për vitin 2018 të AIDSSH-së”. Mbi bazën e këtij dokumenti është mbështetur e gjithë veprimtaria institucionale e AIDSSH-së për vitin 2018, e cila, në terma të përgjithshëm dhe duke konsideruar kushtet në të cilën është ushtruar, pa dyshim mund të

Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit” ka përcaktuar strukturën e AIDSSH-së, sipas së cilës, numri i punonjësve të tij duhet të jetë 60 punonjës në total. Gjatë vitit kalendarik 2018, Autoriteti ka funksionuar me 33 punonjës, nga të cilët 5 janë anëtarë të Autoritetit (vendi vakant i krijuar nga dorëheqja e një anëtari të Autoritetit, akoma nuk është plotësuar nga Kuvendi) të zgjedhur nga



vlërësohet si e suksesshme.

I krijuar prej dy vitesh, AIDSSH akoma nuk ka në dispozicion një godinë me kushte optimale për ruajtjen e dokumenteve arkivore dhe ushtrimin e veprimtarisë së tij. Godina e vënë në dispozicion nga Qeveria shqiptare ishte jofunksionale dhe nuk mundësonte kushtet minimale për transferimin dhe depozitimin e dokumenteve arkivore dhe ushtrimin e veprimtarisë institucionale. Për këtë qëllim, i gjithë fondi i investimeve të vëna në dispozicion për vitin 2018 (pjesa më e madhe në gusht 2018) u kanalizua dhe u prokurua me sukses, në funksion të rikonstruksionit të katit përdhe të godinës, i cili do të shërbejë si mjedis për ruajtjen e dokumenteve arkivore dhe në funksion të drejtorisë së arkivit.

Vendimi nr. 95, datë 22.12.2016, “Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimin e pagave të

Kuvendi sipas ligjit nr. 45/2015, dhe 4 punonjës me kohë të pjesshme. Në këto kushte, stafi i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, veç detyrave funksionale, sipas përshkrimit të punës, ka kryer edhe detyra të tjera të ngarkuara me vendime të Autoritetit dhe urdhra të brendshëm, duke u angazhuar në grupe pune specifike, në funksion të përmbushjes së objektivave kryesorë institucionale, dhe për të krijuar kushtet e nevojshme për përgatitjen e dokumentacionit për realizimin e mbledhjeve të Autoritetit, po ashtu edhe për organizimin e zhvillimin e aktiviteteve të shumta vjetore.

5.1.1 Arkivi

Bazuar në nenin 18 të ligjit nr.45/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë” dhe mbështetur në “Planin vjetor të punës për vitin 2018

të AIDSSH-së”, miratuar me Vendim nr. 28, datë 26.1.2018, objektivat kryesorë në këtë drejtim kanë qenë:

- i. Përfundimi i procesit të inventarizimit të hollësishëm dhe i marrjes në dorëzim i dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit të katër fondeve arkivore;
- ii. Vazhdimi i procesit të punës për identifikimin, mbledhjen dhe administrimin e dokumenteve të tjera të krijuara nga ish-Sigurimi i Shtetit për periudhën 29 nëntor 1944 - 2 korrik 1991;
- iii. Konsolidimi i punës në arkivin e AIDSSH-së sipas legjislacionit në fuqi dhe akteve të tjera të nxjerra nga
- iv. AIDSSH;
- v. Digjitalizimi i dokumenteve arkivore;
- vi. Verifikimi i kërkesave të paraqitura nga institucionet, individët dhe sigurimi i aksesit të qytetarëve, nëpërmjet procedurave të qarta dhe transparente;
- vii. Mbrojtja e të dhënave, në mënyrë të veçantë e atyre të dhënave që përbëjnë informacion të klasifikuar, të dhënave personale dhe e drejta për informim;
- viii. Përgatitja e praktikave dhe dokumenteve përkatëse për deklasifikimin e dokumenteve të ish-Sigurimit;
- ix. Përsheptimi i procedurave në shfrytëzimin e dokumenteve arkivore;
- x. Mirëmbajtja e fondit arkivor;
- xi. Rritja e nivelit dhe aftësive profesionale.

Përfundimi i procesit të inventarizimit të hollësishëm dhe i marrjes në dorëzim i dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit

Në zbatim të ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, të VKM-së nr. 98/2017 “Për përcaktimin e procedurës së kalimit nën administrimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, që gjenden në Ministrinë e Mbrojtjes, Ministrinë e Punëve

të Brendshme, Shërbimin Informativ të Shtetit dhe në autoritetet e tjera publike”, AIDSSH ka nënshkruar marrëveshjet e bashkëpunimit me Ministrinë e Punëve të Brendshme në datën 19.05.2017, Shërbimin Informativ Shtetëror në datën 26.06.2017 dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave në datën 05.05.2017.

Me nënshkrimin e marrëveshjeve me institucionet e mësipërme janë hartuar programet e përbashkëta të grupeve të punës ndërmjet institucioneve dhe ka filluar puna për inventarizimin e hollësishëm dhe marrjen në dorëzim të dokumentacionit arkivor, të përcaktuar në nenin 1 të VKM-së nr. 98/2017.

Procesi i marrjes në dorëzim dhe kalimi në administrim të AIDSSH-së të materialeve arkivore të ish-Sigurimit të Shtetit është mbështetur në identifikimin paraprak të bërë nga secili prej institucioneve të mësipërme.

Gjatë vitit 2018, grupi i punës i ngarkuar me detyrën e marrjes në dorëzim ka vijuar procesin e inventarizimit të hollësishëm dhe të marrjes në dorëzim të fondeve arkivore me vlerë ruajtjeje të përhershme nga Arkivi i Sistemit të Ministrisë së Brendshme.

Procesi i marrjes në dorëzim ka përfshirë verifikimin fletë për fletë të dokumenteve që ndodhen në secilën prej dosjeve, duke bërë ballafaqimin e tyre me të dhënat në inventarët e dosjeve të fondeve arkivore dhe plotësimin e procesverbaleve përkatëse të marrjes në dorëzim. Gjatë procesit të marrjes në dorëzim është kryer verifikimi dhe evidentimi i gjendjes fizike të dokumenteve. Më poshtë kemi paraqitur fondet arkivore të cilat i janë nënshtruar procesit të inventarizimit të hollësishëm dhe marrjes në dorëzim, nga Arkivi i Sistemit të Ministrisë Brendshme tek Arkivi i AIDSSH-së.

- i. Ka përfunduar marrja në dorëzim dhe inventarizimi i Fondit nr. 4, “Drejtorja e Parë e Sigurimit të Shtetit”, në total 8328 dosje dokumentesh arkivore.
- ii. Ka përfunduar marrja në dorëzim dhe inventarizimi i **Fondit 134, “Drejtorja e Dytë e Sigurimit të Shtetit”**. Në total janë marrë në dorëzim 860 dosje

dokumentesh arkivore.

- iii. Ka përfunduar marrja në dorëzim dhe inventarizimi i **Fondit 6, "Drejtoria e Tretë e Sigurimit të Shtetit"**, në total 1003 dosje dokumentesh arkivore.
- iv. Ka përfunduar marrja në dorëzim **Fondi nr.141**, në total **2356** dosje dokumentesh arkivore të vendosura në **148** kuti dhe **56** blloqe e libra të evidencës operative.

Të gjitha dokumentet arkivore të mësipërme janë vendosur në kuti kartoni të pajisura me etiketat përkatëse dhe aktualisht ruhen në ambientin që Arkivi i Ministrisë së Brendshme ka vënë në dispozicion të AIDSSH-së, pranë IPQP.

Sa më sipër, është përmbushur objektivi duke përfunduar procesin e marrjes në dorëzim për të katër fondet arkivore të përcaktuara, me një total prej 12547 dosjesh, sipas grafikut të ilustruar më poshtë:

Të dhënat statistikore të procesit të inventarizimit dhe marrjes në dorëzim të dokumentave arkivor - 2018




Figura 1: Paraqitja grafike e procesit të inventarizimit dhe marrjes në dorëzim të fondeve arkivore

Procesi i marrjes në dorëzim është një proces i vështirë, i cili kërkon kohë të konsiderueshme dhe numër të madh burimesh njerëzore. Ky proces do të vazhdojë

edhe gjatë vitit 2019.

Vazhdimi i procesit të punës për identifikimin, mbledhjen dhe administrimin e dokumenteve të tjera të krijuara nga ish-Sigurimi i Shtetit për periudhën 29 nëntor 1944 - 2 korrik 1991

Identifikimi i dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit ka vijuar jo vetëm me Arkivin e Sistemit të Ministrisë së Brendshme, por edhe me institucione të tjera të rrejtit arkivor, konkretisht: Arkivin Shtetëtor i Sistemit Gjyqësor, Arkivin Qendror të Forcave të Armatosura, Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave, Prokurorinë e Përgjithshme dhe Prokuroritë pranë gjykatave në rrethe. Procesi vazhdon edhe për vitin 2019.



Digjitalizimi i dokumenteve

Digjitalizimi i dokumenteve ka qenë dhe vazhdon të jetë një hallkë e domosdoshme në procesin e trajtimit të kërkesave dhe informimit të qytetarëve e institucioneve mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit. Ky proces i rëndësishëm, edhe gjatë vitit 2018 ka konsistuar në digjitalizimin e dokumenteve dhe mikrofilmave në përmbushjen e kërkesave të ardhura nga individët, institucionet, studiuesit dhe media. Pas procesit të digjitalizimit, dokumentet i janë nënshtruar procedurave të mëtejshme të trajtimit të tyre, siç është anonimizimi i të dhënave sensitive dhe personale.

Dokumentet e digjitalizuara janë organizuar në formën e një arkivi digjital të thjeshtë. Arkivi digjital synon të shërbejë, jo vetëm për të përmbushur kërkesat për informim në dokumentet e ish-Sigurimit të adresuara deri më tani, por edhe si një gur themeli i platformës së komunikimit dhe ndërveprimit që synojmë të ndërtojmë, nëpërmjet së cilës, përdoruesit do të kenë mundësi kërkimi dhe shfrytëzimi të dokumenteve arkivore të krijuara nga strukturat e ish-Sigurimit të Shtetit, të disponuara prej tyre apo që u janë vënë në përdorim, pavarësisht nga forma e ruajtjes veçanërisht, por pa u kufizuar në ato si dosje, të dhëna, shkresa, harta, plane, filma, regjistrime me figurë, me zë dhe regjistrime të tjera.

Për digjitalizimin e dokumenteve dhe mikrofilmave janë përdorur pajisje digjitalizimi profesionale, të dhuruara nga Ambasada Gjermane. Gjatë vitit 2018 janë digjitalizuar gjithsej **119.928** dokumente arkivore. Në projekt tjetër i rëndësishëm me të cilin është angazhuar sektori i digjitalizimit është edhe ai i krijimit të Arkivit të Dëshmive Gojore. Ky projekt synon të realizojë regjistrimin, ruajtjen, arkivimin dhe vënien në dispozicion të dokumenteve audio-vizuale që sjellin historitë e rrëfyera nga vetë të mbijetuarit dhe të përndjekurit nga regjimi komunist. Projekti ka filluar më 20 shkurt 2018 dhe deri në fund të dhjetorit janë arkivuar **30** dëshmi, me një total prej **22** orësh regjistrime. Këto regjistrime ruhen në

pajisje server të dhuruara nga Ambasada Gjermane në Shqipëri. Projekti do të vijojë në 2019.

Verifikimi i kërkesave të paraqitura nga institucionet, individët dhe sigurimi i aksesit të qytetarëve nëpërmjet procedurave të qarta dhe transparente

Trajtimi i kërkesave për informim mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të ardhura nga institucionet, individët dhe studiuesit është një tjetër proces i rëndësishëm pune, i cili kalon nëpër disa etapa: kërkimi për të dhëna dhe dokumente, verifikimi i dokumenteve origjinale në vendruajtjen e dokumenteve dhe përgatitja e tyre sipas rregullave përkatëse për punën me dokumentet arkivore, transportimi fizik i tyre sipas rregullave të përcaktuara (për shkak të mungesës së një ambienti të vetëm për ruajtjen e arkivit të dokumenteve), deklasifikimi (në rastin e dokumenteve të klasifikuara) dhe dhënia për shfrytëzim e dokumenteve origjinale dhe mikrofilmave.

Për vitin 2018 kanë ardhur **789** kërkesa individuale dhe studimore, prej të cilave, deri në fund të vitit 2018 janë përfunduar me përgjigje shkresore nga të dy sektorë **673** kërkesa, sikurse janë paraqitur më poshtë:




Figura 2: Paraqitja grafike e kërkesave individuale dhe kërkesave studimore të përfunduara 2018

Janë mbartur si të papërfunduara në vitin 2019 rreth **116** kërkesa, për arsye se stafi është angazhuar në

kryerjen e disa proceseve të punës.

Gjithashtu, janë verifikuar **67** kërkesa institucionale në kuadër të vlerësimit, sipas legjislacionit përkatës, të cilësive etike, morale dhe profesionale të kandidatëve për t'u emëruar ose ngritur në detyrë.

Ndonëse procesi i kërimit kryhet më së shumti me mjete gjysmë automatike dhe manuale, çka vështirëson së tepërmi punën e arkivistëve dhe ndikon në kohën e shërbimit të vënies në dispozicion të dokumenteve dhe informacionit të kërkuar nga kërkuarit, puna është koordinuar në mënyrë të tillë që shërbimi i dokumenteve të bëhet sa më shpejt dhe me cilësi.

Përgatitja e praktikave dhe dokumenteve përkatëse për deklasifikimin e dokumenteve të ish-Sigurimit

Në funksion të përmbushjes së një prej objektivave kryesorë strategjikë të AIDSSH-së, sigurimin e aksesit në dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, për të gjitha grupet e synuara në ligjin 45/2015, janë marrë të gjitha masat që dokumentet që plotësojnë kriteret ligjore për t'u deklasifikuar, të deklasifikohen. Për këtë qëllim, bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.02.1999 "Për informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror", i ndryshuar dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij, stafi i kësaj drejtorie ka përgatitur praktikat e plota për deklasifikimin e dokumenteve sipas përcaktimeve të ligjeve përkatëse dhe ia ka vënë ato në dispozicion Komisionit për Deklasifikimin dhe Zhvlerësimin (KDZH) e informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror" pranë AIDSSH-së.

Komisioni për Deklasifikimin dhe Zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror", gjatë vitit ka zhvilluar 19 mbledhje dhe ka marrë 19 vendime për deklasifikimin plotësisht të 241 dosjeve/fashikujve e 31 fletëve regjistra dhe kartela, me volum prej 33 700 fletë dokumente, të cilat kanë qenë të klasifikuara në nivelin "sekret" dhe "tepër sekret".

Më poshtë janë paraqitur të dhënat e dokumenteve të deklasifikuara, të grupuara sipas numrit të vendimeve.

Numri i dokumenteve të deklasifikuara




Figura 3: Dokumentet e deklasifikuara sipas vendimeve të KDZH-së, për vitin 2018

Pas procesit të deklasifikimit, dokumentet janë vënë në dispozicion të Drejtorisë së Informacionit për trajtimin e mëtejshëm. Gjithashtu, është bërë publik informacioni për dokumentet e deklasifikuara.

5.1.2 Informacioni

Ligji nr. 45/2015 parashikon se çdo person ka të drejtë të kërkojë nga Autoriteti të informohet nëse në dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit ka informacione për personin e tij dhe t'i marrë këto informacione, kur ka të tilla, sipas këtij ligji. Autoritetet publike dhe subjektet e tjera, të parashikuara nga ky ligj, kanë akses në dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, vetëm për atë që lejohet nga ligji. Autoriteti vë në dispozicion të autoriteteve shtetërore përkatëse çdo informacion të siguar gjatë veprimtarisë së tij, kur kjo kërkohet për qëllime të hetimit dhe ndjekjes penale.

Një nga përgjegjësitë e Autoritetit, sipas nenit 10 të ligjit nr. 45/2015 është dhënia e informacioneve dhe e njoftimeve mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, si dhe garantimi i shqyrtimit dhe dorëzimi i tyre për kërkuesit. Ligji parashikon në tërësinë e tij garantimin e të drejtës për informim për personat për të cilët ish-Sigurimi i Shtetit ka mbledhur të dhëna; për bashkëpunëtorët e ish-Sigurimit të Shtetit, të favorizuarit, institucionet, të interesuarit për qëllime hulumtuese, historike e të rivlerësimit politik dhe mediat. Përcaktimi i rregullave dhe procedurave të detajuara sipas subjektit kërkues garanton për çdo rast, të drejtën e jetës private të të tretëve, sipas vlerësimit të interesave të ligjshme. Theksojmë se baza për procesin e informimit të subjekteve kërkues që kërkojnë informimin mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit janë: Ligji nr. 45/2015, ligji nr. 9877/2008 *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”*, *“Rregullorja e brendshme e institucionit”*, miratuar me Vendim të Autoritetit nr. 21, datë 09.05.2017, Rregullorja *“Për Mbrojtjen, Përpunimin, Ruajtjen dhe Sigurinë e të dhënave personale në AIDSSH”*, miratuar me vendim të Autoritetit nr. 25, datë 25.05.2017, Urdhri Nr. 10, datë 30.01.2017 *“Mbi politikën dhe procedurat për trajtimin e kërkesave individuale për informim pranë Autoritetit”* dhe Urdhri Nr. 11, datë 30.01.2017 *“Mbi politikën dhe procedurat për trajtimin e kërkesave për informimin e institucioneve kushtetuese, autoriteteve publike*

dhe personave privatë”, të miratuara me Vendim të Autoritetit, Rregullorja *“Mbi publikimin e veprimtarisë së Autoritetit në ushtrim të detyrave funksionale të ngarkuara me ligj”*, miratuar me vendim të Autoritetit nr. 88, datë 22.02.2019.

Trajtimi i kërkesave individuale për informim

Në funksion të rritjes së efektivitetit dhe eficiencës së punës për përmbushjen në kohë dhe me cilësi të kërkesave për informim, të paraqitura pranë Autoritetit nga kërkuesit, në cilësinë e personave të interesuar, persona të prekur, palëve të treta, bashkëpunëtorëve apo të favorizuarve nga ish-Sigurimi i Shtetit, është zhvilluar gjithë procedura ligjore mbështetur në ligjin 45/2015 në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të këtij ligji, si dhe aktet normuese që rregullojnë veprimtarinë e AIDSSH-së.

Mbështetur në pikën 4 të Planit Strategjik, stafi teknik i AIDSSH ka qenë i kujdesshëm në mbrojtje të privatësisë dhe dispozitave të tjera ligjore përkatëse, por gjithmonë duke u mbështetur fort në vlerat e transparencës që i ka në misionin e vet, duke bërë që ligji i transparencës të prevalojë mbi atë të privatësisë, për atë që ka qenë e mundur. Mbështetur në këtë parim, jemi përpjekur t'i shpjegojmë dhe të marrim mirëkuptimin e çdo kërkuesi, i cili është paraqitur pranë zyrave të Autoritetit për t'u njohur dhe tërhequr dokumente të krijuara nga ana e organeve të ish-Sigurimit të Shtetit, të gjetur në arkivat e institucionit, se ky proces ka dhe disa detyrime ligjore të cilat i kërkon ligji nr. 9887/2008 *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”* i ndryshuar.

Në këtë kuadër, janë ndërmarrë hapa dhe ndërtuar punë konkrete nga AIDSSH, nëpërmjet studimit dhe përditësimit me çdo literaturë dhe bazën ligjore në qarkullim, si dhe duke kërkuar ndihmë për asistencë (trajtime) nga Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, shkresa nr. prot. 478, datë 19.06.2018, Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, nr. prot. 489, datë 20.06.2018 i ndryshuar.

Me ndihmën dhe asistencën e OSBE-së është

organizuar një trajnim në qytetin e Beratit në datat 17-18 korrik 2018, me temë: “Procedura dhe hapat që duhet të ndiqen në procesin e anonimizimit”, kjo në kuptim të mbrojtjes së të dhënave personale, në referim të ligjit nr. 9887/2008, i ndryshuar.



Aspekt tjetër që vlen të përmendet është dhe asistimi apo orientimi sipas ligjit, që stafi teknik i AIDSSH-së u ka dhënë subjekteve kërkuese gjatë plotësimit të formularëve të aplikimit.

Nisur nga treguesit e pasqyruar në këtë raport vjetor, rezulton se numri i kërkesave individuale për informim të paraqitura në adresë të Autoritetit gjatë vitit 2017, gjatë vitit 2018 ka trend rritës mbi 50% në krahasim me vitin 2018 dhe konkretisht:

- Gjatë vitit 2018, janë paraqitur 612 aplikime nga subjekte në cilësinë e të prekurit apo familjarit të të vdekurit apo zhdukurit;
- Janë përmblyllur procedurat për 305 kërkesa individuale.
- Për 174 kërkesa individuale për të cilat janë mbyllur procedurat, ka rezultuar se ka dokumente të krijuara nga ana e organeve të ish-Sigurimit të Shtetit. Ky dokumentacion është marrë nga drejtorja e arkivit, është përpunuar dhe shqyrtuar sipas kriterëve ligjore nga ana e drejtorisë së informacionit, duke filluar nga përgatitja e relacioneve, materialet mbështetëse, vendimet, procesverbalet dhe kthimet

e përgjigjeve kërkuese, mbi bazën e vendimmarrjes nga Autoriteti, për mbylljen e procedurës dhe dhënien e dokumentacionit dublikatë aplikuesve.

- Për 131 kërkesa individuale, pas verifikimit nga ana e drejtorisë së arkivit ka rezultuar se nuk ka të dhëna/dokumente të krijuara nga ana e organeve të ish-Sigurimit të Shtetit. Drejtorja e informacionit ka vijuar procedurën me përgatitjen e relacionit, vendimeve përkatëse dhe shkresës për përcjellje të vendimeve subjekteve aplikues, me qëllim mbylljen e procedurës.
- Janë përgatitur 44 mbledhje, të shoqëruara në çdo rast me bazën e nevojshme dokumentare, si relacionet përkatëse, draft vendime dhe sipas rastit, materiale ndihmëse dhe shtesë, në funksion të përmbushjes së detyrave dhe urdhërimeve të bëra nga anëtarët, në çdo rast të përgatitura nga sektori i kërkesave individuale për informim.


Rritje të efektivitetit dhe eficiencës kanë pasur edhe procedurat e zhvilluara për vënien në dispozicion të dosjeve publikut. Mbështetur në objektivin strategjik, 1.2 “Vendosja e dosjeve në dispozicion të publikut sipas dispozitave të parashikuara në ligj, duke përfshirë sigurimin e aksesit në informacionin në formë digjitale”, AIDSSH i ka kushtuar kujdes të veçantë balancimit të parimeve konkurruese të transparencës dhe privatësisë, duke i dhënë paritet misionit të saj informim me transparencë, duke i dhënë përparësi transparencës mbi privatësinë, kur ka qenë e mundur.

Në këtë kuadër vlen të theksohet se, pavarësisht mungesës së stafit, gjatë vitit 2018, AIDSSH ka bërë të mundur shqyrtimin, verifikimin dhe përpunimin e **612** kërkesave individuale, të përfunduara me vendimmarrje të Autoritetit janë **305** kërkesa, nga të cilat **174** prej tyre kanë rezultuar me të dhëna, sipas rastit dosje formulare, përpunimi, pune, personale, operative dhe hetimore – gjyqësore dhe **131 kërkesa kanë** rezultuar pa dokumentacion arkivor. Numri i dokumenteve të përpunuara, të njohura dhe dorëzuara te kërkuessit

gjatë vitit 2018 është gjithsej **42.149 faqe**, nga të cilat **14.983 faqe të anonimizuara**.


Në krahasim me vitin 2017, kemi rritje të numrit të aplikimeve dhe të rasteve të shërbyera, si në planin sasior edhe cilësor, falë përmirësimit relativisht të kushteve të punës me zgjerimin e disa ambienteve, shtimit të organikës dhe asistencës teknike të dhënë me vlerë të veçantë nga Ambasada Gjermane, etj.

- Në planin krahasues dhe të treguesve të aktivitetit të zhvilluar; për vitin 2017 (281 kërkesa individuale) dhe viti 2018 (612 kërkesa, të mbyllura 305, në proces 307) në total rritje e konsiderueshme, trend në ngritje edhe për vitin në vijim.



- Numri i dokumenteve të përpunuara gjatë vitit 2018, të cilat janë njohur dhe dorëzuar te kërkuarit ka arritur në 42.149 faqe, nga të cilat 14.983 faqe të anonimizuara.
- Numri i dokumenteve të përpunuara gjatë vitit 2017 të cilat janë njohur dhe dorëzuar te kërkuarit ka qenë rreth 30.000 faqe, nga të cilat 9.000 faqe të

anonimizuara.



Nëse vërejmë me vëmendje edhe treguesit e dokumenteve të njohura dhe dorëzuara kërkuarve, në krahasim me vitin e parë të ushtrimit të aktivitetit nga institucioni ynë, në veçanti, treguesit sasiorë dhe cilësorë, si dhe të performancës, konstatohet rritje e ndjeshme, ndonëse infrastruktura dhe numri i punonjësve kanë pësuar ndryshime dhe përmirësime ende të pandjeshme, megjithatë, treguesit dhe rezultatet kanë qenë të kënaqshme e mbresëlënëse.

Trajtimi i kërkesave për informim për institucionet apo autoritetet publike

Institucionet kushtetuese, autoritetet publike, në zbatim të detyrimeve ligjore që rrjedhin nga ligji nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të RPSSH”, kanë detyrimin ligjor për t’i kërkuar Autoritetit nëse ekzistojnë informacione në dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, në kuadër të vlerësimit të cilësive etike, morale dhe profesionale të kandidatëve që kanë aplikuar për emërim apo ngritje në detyrë.

Në veprimtarinë e tij, Autoriteti udhëhiqet nga parimet e ligjshmërisë, transparencës, eficiencës dhe efektivitetit, mbrojtjes së interesit publik dhe sigurisë kombëtare, mbrojtjes së të drejtës për jetë private dhe të dhënave personale të parashikuara në ligjin 45/2015, 219, dhe aktet e tjera ligjore.

Bazuar në nenin 10, nenin 26 e vijues të ligjit nr. 45/2015, Autoriteti, me vendim të arsyetuar, në çdo rast, informon institucionin përkatës për informacionin që kërkohet, me shkresën respektive.

Për sa i takon vitit 2018, bazuar në parashikimet ligjore të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" dhe ligjit nr. 45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", ju informojmë se nga ana e AIDSSH-së janë verifikuar të gjitha kërkesat e paraqitura nga ana e institucioneve kushtetuese, autoritetet publike në rastet e emërimeve ose të ngritjes në detyrë dhe me kërkesë të kandidatëve për t'u zgjedhur.

Kërkesat e paraqitura në AIDSSH nga institucionet apo autoritetet publike, të cilët janë subjekt i ligjit 45/2015, lidhur me ekzistencën e informacioneve në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit, në kuadër të vlerësimit të cilësive etike, morale dhe profesionale të kandidatëve/zyrtarëve përpara emërimit apo ngritjes në detyrë, jo vetëm që janë trajtuar me prioritet, fillimisht për legjitimitetin e tyre në mbledhje të Autoritetit, por ajo që është më e rëndësishmja, rezultatet e verifikimit për çdo rast u janë komunikuar institucioneve që kanë paraqitur kërkesën dhe në asnjë rast nuk ka pasur nga ana jonë ndërprerje të procesit të filluar. Vlen të përmendet kryerja në veçanti e procedurave të vlerësimit të cilësive etike, morale dhe profesionale të kandidatëve për t'u zgjedhur në organet e vettingut dhe atyre për t'u zgjedhur në KLP dhe KLGJ, jo vetëm brenda standardeve të kërkuara dhe në kohë të shkurtër, por më e rëndësishmja, brenda kornizave që i ngarkon ligji. Pra, roli që ligji i njeh Autoritetit në këtë

drejtim është mjaftueshmërisht i drejtpërdrejtë, me vënien e informacionit në dispozicion sipas kërkesës dhe jo kompetenca të shtuara mbi kandidatët/zyrtarët për emërim apo promovim në institucione kushtetuese apo autoritete publike. Në këtë kontekst, vlerësimi i rezultateve të verifikimeve të kandidatëve/zyrtarëve mbetet në diskrecion të institucionit kërkues, për sa i takon kushteve penguese për t'u emëruar apo ngritur në detyrë apo për t'u zgjedhur, bazuar edhe në legjislacionin përkatës.

Për vitin 2018 janë trajtuar **67** kërkesa, nga të cilat:


- janë verifikuar **463** kandidatë apo zyrtarë, nga të cilët:
 - **446** individë rezultojnë negativ (figura të pastra)
 - **17** individë kanë rezultuar pozitiv (figurojnë në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit në cilësi të ndryshme që nga subjekte procedues, anëtar ose b.p.)

Nëse vërejmë në rrafshin krahasues në vitin 2018, kemi rritje të numrit të kërkesave, por njëherazi zvogëlim të numrit të personave të verifikuar, për vetë stabilitetin, dinamikën e zhvillimeve dhe rekrutimeve në administratë, pasi në vitin pararendës kemi pasur ngritjen (krijimin) e disa institucioneve të reja, sidomos të atyre në drejtësi dhe procesin elektoral, ku në proceset e verifikimit u përfshinë disa subjekte politike, çka ka rritur numrin e individëve të verifikuar.

E veçanta e vitit 2018 është numri në rritje i kërkesave edhe për raste të veçanta, që tregojnë sensibilitetin dhe kuptimin më të drejtë e rritjen e shkallës së përgjegjshmërisë dhe të kuptimit të procesit nga ana e institucioneve dhe administratës publike.

Gjatë vitit **2017**, janë trajtuar **48** kërkesa (institucione kushtetuese apo autoritete publike), ku janë verifikuar 821 kandidatë apo zyrtarë;

Në vitin **2018**, janë trajtuar **67** kërkesa, nga të cilat janë verifikuar **463** kandidatë apo zyrtarë.



Ajo që bie në sy dhe në konceptimin tonë përbën tregues pozitiv, mbeten rezultatet e verifikimeve dhe numri në rritje i konstatimit të personave me rekorde pozitive, tregues i cilësisë së kërkimit, identifikimit të dokumentacionit dhe stabilitetit të procesit në tërësi, proces i cili në vijimësi do të vijë në përmirësim, duke synuar që në të ardhmen të ulim në mënyrë të ndjeshme numrin e ankesave dhe kontestimeve.

Në ushtrim të veprimtarisë sonë, gjatë këtyre dy viteve kanë rezultuar gjithsej 30 persona pozitiv (figurojnë në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit kryesisht b.p) nga të cilët, në konkretizim të sa më sipër 13 rezultojnë pozitiv (figurojnë në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit) vetëm për vitin 2017, ndërsa pjesa tjetër i përket rekordeve të vitit 2018.

Shtetas të verifikuar në kuadër të vlerësimit të cilësive etike, morale dhe profesionale të kandidatëve/zyrtarëve përpara emërimit apo ngritjes në detyrë




Figura 4: Të dhëna dhe shifra në lidhje me verifikimin e kandidatëve/zyrtarëve përpara emërimit në detyrë, 2018

Institucionet kushtetuese apo autoritetet publike që kanë paraqitur kërkesa (një ose më shumë në kohë të ndryshme) të cilat janë trajtuar pranë AIDSSH-së:

Institucioni i Presidentit të Republikës, Kuvendi i Shqipërisë, Avokati i Popullit, subjekte politike, Ministria e Bujqësisë, Ministria e Brendshme (Drejtoria e Përgjithshme e Policisë), Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Qendra e Studimeve Albanologjike, Rektorati i UT, Fakulteti Ekonomik i UT, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja i UT, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, etj. Janë verifikuar figura qendrore me peshë dhe rëndësi në jetën politike të vendit, si Presidenti i Republikës, Anëtarë të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, si dhe gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit (Vettingu), Anëtarë të KLGJ-së, Anëtarë të KLP-së, gjeneralë, Avokati i Popullit, anëtarë të KOZ-së, anëtarë të Akademisë së Shkencave, Prokurori i Përgjithshëm i Përkohshëm, etj, çka përbëjnë përparim në koeficientin

e njohjes dhe zbatimit të ligjit, vlerësim për institucionin dhe besueshmëri për publikun.

- Kryesisht po paraqesim statistika përgjithësuese në këtë drejtim:
- Nga verifikimet e kryera deri tani, ka rezultuar se figurojnë në dokumentacionin e ish-Sigurimit të Shtetit me të dhëna, gjithsej 30 (tridhjetë) persona.
- Në lidhje me zgjedhjen në organet e larta të drejtësisë janë verifikuar nga ana jonë 294 kandidatë, nga të cilët për 5 (pesë) individë ka rezultuar të figurojnë dhe të ketë dokumentacion pranë institucionit tonë.

Më konkretisht:

1. Me kërkesë nga Avokatit të Popullit janë verifikuar kandidatët për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.
 - Nga verifikimi, Autoriteti ka dalë me Vendimin nr.11 datë 24.03.2017, sipas të cilit për 3 persona rezultoi se figurojnë në dokumentacionin e ish-Sigurimit të Shtetit, 2 persona si subjekte proceduese ish-gjyqtar dhe ish-prokuror në procese penale politike (**NS, FL**) dhe për 1 person si bashkëpunëtor (**SV**). Ky rast është marrë në shqyrtim nga ana jonë, bazuar në kërkesën për korrigjim nga ana e subjektit dhe është lënë në fuqi nga Autoriteti me Vendimin nr. 44, datë 16.02.2018. Rasti është në proces gjyqësor.
 - Vendimi i është dërguar Avokatit të Popullit, i cili kishte tagrin ligjor për të njohur, vlerësuar dhe zbatuar informacionin e dërguar nga ana jonë.
 - Gjithashtu, me Vendimin nr. 33, datë 05.02.2018 (marrë në shqyrtim kryesisht), me objekt shqyrtimi i publikimeve për pastërtinë e figurës së kandidatit për anëtar të KLP (KJ), duke vendosur korrigjimin e Vendimit nr. 11, datë 24.03.2017 për shtetasin (**KJ**). Vendimi është marrë në fillimin e veprimtarisë së Autoritetit, kohë kur identifikimi

dhe gjetja e dokumentacionit realizohej nëpërmjet institucioneve të tjera. Rasti është në proces gjyqësor.

2. Me kërkesë nga Prokuroria e Përgjithshme është bërë verifikimi i figurës për kandidat për anëtar të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.
 - Nga verifikimi, Autoriteti ka dalë me vendimin Nr.12, datë 22.01.2019, që ka të bëjë me subjektin e verifikuar (**BSH**), për të cilin ka rezultuar se figuron në dokumentacionin e ish-Sigurimit të Shtetit. Rasti është në shqyrtim administrativ nga ana jonë, me kërkesë të vetë subjektit të verifikuar. Gjithashtu, po ndiqet dhe në rrugë procedurale nga ana e Prokurorisë.
3. Me kërkesë të dy partive politike (Drejtësi, Integrim dhe Unitet; Aleanca Popullore për Drejtësi), në mbështetje të fushatës sensibilizuese të institucionit tonë, janë verifikuar 285 persona në kuadër të verifikimit të figurës për kandidat për deputet në Kuvendin e Shqipërisë për zgjedhjet e 25 Qershorit.
 - Nga verifikimi, Autoriteti ka dalë me vendimet Nr.30 datë 25.05.2017, dhe Nr.3, datë 05.06.2017, sipas të cilëve 4 persona figurojnë në dokumentacionin e ish-Sigurimit të Shtetit (**XHA, RT, FT, ZG**).
 - Vendimet u janë dërguar subjekteve kërkuese.
4. Me kërkesë nga Ministria e Brendshme, janë verifikuar 30 persona në kuadër të verifikimit të figurës përpara emërimeve ose të ngritjes në detyrë.
 - Nga verifikimi, Autoriteti ka dalë me Vendimin nr. 40, datë 22.06.2017, sipas të cilit **1(një)** person figuron në dokumentacionin e ish-Sigurimit të Shtetit (**AXH**).
 - Vendimi i është dërguar Ministrisë së Brendshme, e cila kishte tagrin ligjor për të njohur, vlerësuar dhe zbatuar informacionin e dërguar nga ana jonë. Në ligj nuk ka parashikime që të informohemi mbi ecurinë e mëtejshme në lidhje me subjek-

tet e verifikuara.

5. Me kërkesë nga Akademia e Shkencave janë verifikuar të gjitha kandidaturat në kuadër të verifikimit të figurës përpara emërimeve ose ngritjes në detyrë.

- Nga verifikimi, Autoriteti ka dalë me vendimin Nr.51, datë 01.08.2017, sipas të cilit 2 persona figurojnë në dokumentacionin e ish-Sigurimit të Shtetit (**GjSh, IM**).
- Vendimi i është dërguar Akademisë së Shkencave, e cila kishte tagrin ligjor për të njohur, vlerësuar dhe zbatuar informacionin e dërguar nga ana jonë.

6. Me kërkesë nga Fakulteti Ekonomik, Universiteti i Tiranës, në kuadër të fushatës sensibilizuese të institucionit tonë, janë verifikuar 116 persona, të cilët kanë plotësuar formularët e aplikimit për individ.

- Nga verifikimi, Autoriteti ka dalë me Vendimin nr. 64, datë 25.10.2017, sipas të cilit **2 (dy)** persona figurojnë në dokumentacionin e ish-Sigurimit të Shtetit (**AM, IK**).
- Njoftimi mbi rezultatet e verifikimit u është dërguar të gjithë aplikuesve.

7. Me kërkesë nga MEPJ janë verifikuar 234 persona, në kuadër të verifikimit të cilësive etike, morale dhe profesionale të figurës, bazuar në Ligjin 23/2015, "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë".

- Nga verifikimi, Autoriteti ka dalë me vendimet: Nr.72, datë 24.04.2018 (**FR**); Nr.73, datë 24.04.2018 (**EM**); Nr.74, datë 24.04.2018 (**LIK**); Nr.75, datë 24.04.2018 (**JSh**); Nr.76, datë 24.04.2018 (**GS**); Nr.77 datë 24.04.2018 (**AA**); Nr.79 datë 24.04.2018 (**AD**), sipas të

cilëve 7 persona figurojnë në dokumentacionin e ish-Sigurimit të Shtetit.

- Nga këto vendime janë ankimuar vetëm dy prej tyre dhe konkretisht Vendimi nr. 74, datë 24.04.2018 (**LIK**), i cili, pasi u shqyrtua në Autoritet, mbi bazën e ankimit të subjektit të verifikuar, me vendim të arsyetuar, mbi bazën e provave të paraqitura dhe nga kërkimi i thelluar është vendosur ndryshimi i tij. Kjo, pasi rezultoi se kishim të bënim me person tjetër me gjeneralitete të njëjta, që në kohën e rekrutimit, subjekti i verifikuar nga ana jonë ndodhej jashtë juridiksionit në të cilin ishte krijuar dhe gjendej dokumentacioni dhe në këtë kontekst, Autoriteti korrigjoi vendimin përkatës. Gjithashtu, ndaj Vendimit nr. 75, datë 24.04.2018, është bërë ankim pranë Autoritetit, i cili, pasi e ka marrë në shqyrtim me Vendimin nr. 370, datë 19.10.2018, ka vendosur lënien në fuqi të Vendimit nr. 75, datë 24.04.2018. Rasti është për shqyrtim në gjykatë.

- Gjithashtu, rasti i verifikimit për punonjësin e kësaj ministrie (**VM**), gjatë procesit u konstatua se kishte qenë subjekt i verifikimit nga ana e Komisionit "Bezhani", shkak për të cilin verifikimi u ndërpre.

- Vendimi u është dërguar subjekteve përkatëse, që kanë tagrin ligjor për të njohur, vlerësuar dhe zbatuar informacionin e dërguar nga ana jonë. Në ligj nuk ka parashikime që të informohemi mbi ecurinë e mëtejshme në lidhje me subjektet e verifikuara.

8. Me kërkesë nga SHISH kanë ardhur për verifikim 45 persona, në kuadër të verifikimit të cilësive etike, morale dhe profesionale të figurës, nga të cilët janë verifikuar 50% persona, pjesa tjetër janë në proces verifikimi.

- Nga verifikimi, Autoriteti ka dalë me vendimet: Nr.161, datë 05.06.2018 (**KP**); Nr.390, datë 25.10.2018 (**QD**); Nr.390 datë 25.10.2018 (**RM**), sipas të cilëve 3(tre) persona figurojnë në

dokumentacionin e ish-Sigurimit të Shtetit.

- Vendimet i janë dërguar subjektit kërkuar, që ka tagrin ligjor për të njohur, vlerësuar dhe zbatuar informacionin e dërguar nga ana jonë. Në ligj nuk ka parashikime që të informohemi mbi ecurinë e mëtejshme në lidhje me subjektet e verifikuara.

- Në dijëni të Ministrisë së Brendshme dhe me kërkesë nga organet e pushtetit vendor, janë verifikuar 25 persona në kuadër të verifikimit të cilësive etike, morale dhe profesionale.

- Nga verifikimi, Autoriteti ka dalë me vendimet Nr.326, datë 01.10.2018, sipas të cilit rezultoi se **(DHS)** figuron në dokumentacionin e ish-Sigurimit të Shtetit. Rasti ndodhet në proces të shqyrtimit administrativ. Po kështu, me Vendimin nr.389, datë 25.10.2018, rezultoi se **(ZK)** figuron në dokumentacionin e ish-Sigurimit të Shtetit.

- Vendimi u është dërguar subjekteve përkatëse, që kanë tagrin ligjor për të njohur, vlerësuar dhe zbatuar informacionin e dërguar nga ana jonë.

9. Me kërkesë nga Garda e Republikës, Ministria e Brendshme, janë verifikuar 7 persona në kuadër të verifikimit të figurës.

- Nga verifikimi, Autoriteti ka dalë me vendimin Nr.414, datë 08.11.2018, sipas të cilit 1 (një) person figuron në dokumentacionin e ish-Sigurimit të Shtetit **(QP)**.

- Vendimi i është dërguar Gardës së Republikës dhe Ministrisë së Brendshme, të cilat kishin tagrin ligjor për të njohur, vlerësuar dhe zbatuar informacionin e dërguar nga ana jonë.

10. Me kërkesë nga Avokati i Popullit, janë verifikuar në kuadër të verifikimit, të cilësive etike, morale dhe profesionale kandidatët për Komisioner pranë këtij institucioni.

- Nga verifikimi, Autoriteti ka dalë me Vendimin nr. 419, datë 18.10.2018, sipas të cilit 1 (një) person **(SN)** figuron në dokumentacionin e ish-Sigurimit të Shtetit.

- Vendimi i është dërguar Avokatit të Popullit, i cili kishte tagrin ligjor për të njohur, vlerësuar dhe zbatuar informacionin e dërguar nga ana jonë.

11. Me kërkesë nga Kuvendi i Shqipërisë janë verifikuar kandidaturat në kuadër të verifikimit të cilësive etike, morale dhe profesionale të kandidatëve për anëtar në Këshillin Drejtues të Radio Televizionit Publik Shqiptar.


- Nga verifikimi, Autoriteti ka dalë me vendimet Nr.256, datë 29.08.2018, dhe Nr.323, datë 21.09.2018, sipas të cilëve 1 (një) person **(PP)** figuron i regjistruar si bashkëpunëtor në dokumentacionin e ish-Sigurimit të Shtetit. Vendimi është ankimuar nga subjekti i verifikuar dhe është lënë në fuqi nga ana e Autoritetit.

Trajtimi i kërkesave individuale për qëllime rehabilitimi ose dëmshpërblimi

Objekt trajtimi kanë qenë edhe kërkesat e ardhura nga Ministria e Drejtësisë për verifikimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist, për efekt të dëmshpërblimit financiar, sipas ligjit nr. 9831/2007, i ndryshuar. Në aspektin statistikor rezultoi se:


Gjatë vitit 2018, për qëllime rehabilitimi dhe dëmshpërblimi janë paraqitur 184 kërkesa të reja nga Ministria e Drejtësisë, nga të cilat 155 janë trajtuar dhe kthyer përgjigje Ministrisë së Drejtësisë, 29 kërkesa janë në proces verifikimi, përmbyllja e të cilave do të realizohet gjatë këtij viti.

Krahasuar me vitin 2017, në sektor kanë ardhur 95 kërkesa nga Ministria e Drejtësisë për efekt dëmshpërblimi, për të cilat, pasi janë kryer të gjitha procedurat e brendshme për kontrollin dhe gjetjen e materialeve të kërkuara dhe është arritur të kthehet përgjigje për 65 prej tyre, pjesa tjetër është mbartur dhe përmbyllur gjatë vitit 2018.



kërkesa, lehtësisht konstatohet trendi në ulje, ç'ka të bëjë dhe me ecurinë e procesit të dëshmshpërblimeve, i cili gradualisht po hyn në fazën përmblylëse të tij.

Autoriteti, gjatë ushtrimit të detyrave funksionale që ligji i ngarkon, në faqen zyrtare dhe përmes buletinit (në letër apo online), ka publikuar në vijimësi të gjitha vendimet e tij, si dhe veprimtari të tjera, si ekspozita dokumentare, publikime të kërkimit dhe artikujve shkencorë, dokumente dhe dëshmi, në kushtet e masave organizative dhe teknike bashkëkohore, për mbrojtjen, sigurinë dhe administrimin e të dhënave personale në dokumentet e prodhuara nga institucioni.



Konferenca e parë ndërkombëtare shkencore: "Të mohuar nga regjimi: burgjet, sistemi i internim-dëbimeve dhe puna e detyruar në Shqipërinë e viteve 1945-1990"

Vlen të theksohet fakti se kërkesat e para për këtë proces kanë filluar në muajin gusht 2017. Nëse analizojmë trendin, duke marrë në konsideratë faktin se vetëm në 4 muajt e fundit të vitit 2017 kanë ardhur 95 kërkesa, ndërsa për 12 muajt e vitit në shqyrtim 184

5.1.3 Hulumtimi Shkencor dhe Edukimi Qytetar

Autoriteti, nëpërmjet Drejtorisë së Mbështetjes Shkencore dhe Edukimit Qytetar e ka fokusuar punën në dy drejtime kryesore, mbështetjen shkencore dhe edukimin qytetar. Gjatë vitit 2018 ka pasur aktivitet të ngjeshur, i cili reflektohet nga rritja domethënëse e numrit të kërkesave studimore dhe kërkesave të paraqitura nga media të ndryshme, si dhe numrin e veprimtarive shkencore dhe përkujtime të organizuara në bashkëpunim me partnerë, institucione homologe, komunitetin dhe ish-të përndjekurve dhe të afërm të tyre, në koordinim të përhershëm me mediat.

Më poshtë jepen të detajuara sipas seksioneve përkatëse dhe në rend kronologjik aktivitetet e institucionit gjatë vitit 2018.

Mbështetja shkencore

Mbështetja shkencore bazohet kryesisht në përpunimin e kërkesave individuale të studiuesve dhe medias për qëllime studimore dhe vënies në dispozicion të tyre të dokumentacionit arkivor të kërkuar. Ky proces, sa i thjeshtë në dukje është njëkohësisht mjaft kompleks, për shkak se ai duhet të kalojë nëpër korridoret e përcaktuara nga disa ligje të rëndësishme siç janë ligji 45/2015, ligji për mbrojtjen e të dhënave personale, ligji për dokumentet e klasifikuara, ligji për arkivat, etj.

Për përmbushjen me sukses të kësaj detyre, AIDSSH ka forcuar kapacitetet administrative dhe ka siguruar infrastrukturën e nevojshme për studiuesit, me qëllim aksesin sa më të gjerë për subjektet e interesuara në dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, si më poshtë vijon:

- Është krijuar një bazë të dhënash për regjistrimin e të dhënave që kanë bëjnë me të gjitha etapat e trajtimit të kërkesave (studimore dhe media) që nga momenti i regjistrimit në protokoll, kalimi i kërkesës në mbledhjet e Autoritetit, përcjellja e saj në drejtorinë e arkivit, vendimarrja e Autoritetit për dokumentet

e gjetura dhe deri në vënien në dispozicion të dokumenteve. Kjo bazë të dhënash shërben si mjet shumë i rëndësishëm për identifikimin në çdo kohë të statusit të kërkesave dhe evidentimit të dokumenteve të digjitalizuara e të anonimizuara.

- Janë përmirësuar procedurat e ndjekura për verifikimin e subjekteve, për ta bërë procesin lehtësisht të kuptueshëm për palët e interesuara dhe plotësisht të realizueshëm për vetë institucionin, nëpërmjet rishikimit të formularit të aplikimit për studiues, media, përmirësimit të seksioneve të formularit, për të qenë më të kuptueshëm për studiuesit apo mediat e interesuara, për të marrë informacion nga arkivi i AIDSSH-së; krijimi i mundësisë së aplikimit, si në formë elektronike, në faqen zyrtare të Autoritetit, ashtu edhe në letër, pranë zyrave të AIDSSH-së.
- Për rritjen e cilësisë së studimeve, në formular është parashikuar një hapësirë ku të vendosen të gjitha detajet e kërkesës si dhe qëllimi i saj, duke motivuar arsyen për të cilën dokumentet do të përdoren nga studiuesit. Në rregulloren e brendshme të mbarëvajtjes së punës së Autoritetit janë parashikuar disa kriteret bazë të studiuesve dhe aplikantëve që kërkojnë të informohen mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit. Kjo për të ndihmuar procesin, si nga ana praktike, ashtu edhe nga ana cilësore e studimeve.
- Një element i rëndësishëm që i është shtuar procesit të informimit për studiues e media është nënshkrimi i Deklaratës së Konfidencialitetit, me të cilën vetë studiuesi/kërkuesi, merr përgjegjësinë e mosshpërdorimit të informacionit të marrë nga dokumentet e vëna në dispozicion nga Autoriteti dhe trajtimin e të dhënave personale dhe sensitive konform ligjit të posaçëm.

Gjatë vitit 2018 janë trajtuar dhe mbyllur 106 praktika (këtu futen të gjitha kërkesat studimore/mediatike të

cilat i kanë kaluar të gjitha fazat e trajtimit), për të cilat, në varësi të gjetjes ose jo të dokumenteve të kërkuara, janë mbyllur me vendim të Autoritetit.

Është gjetur dhe është dhënë informacion i pjesshëm dokumentesh për 40 kërkesa studimore (këtu futen të gjitha ato kërkesa që janë në proces, por që nisur nga tipologjia e kërkesave studimore, në shumë raste me më shumë se një dosje për kërkesë, janë gjetur dhe janë vënë në dispozicion një pjesë e dokumenteve të kërkuara. Për të tjerat vijon procesi i kërkimit).

Janë në proces përpunimi 46 praktika (këtu futen të gjitha praktikat e legjitimuara, për të cilat i është dërguar shkresë arkivit për identifikimin dhe vënien në dispozicion të dokumenteve të gjetura).



Aktiviteti për hapjen e dosjeve të zonës së Konispolit, përndjekja në breza

Edukimi qytetar

Edukimi qytetar me fokus informimin e qytetarëve, ndërgjegjësimin e shoqërisë në përgjithësi dhe e të rinjve në veçanti është një tjetër objektivi i rëndësishëm i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit. Në funksion të këtij objektivi, duke u mbështetur në kalendarin e kujtesës dhe në detyrat

të caktuara nga rezoluta e Kuvendit, AIDSSH ka ndërmarrë dhe ka organizuar një sërë projektesh dhe aktiviteteve gjatë vitit 2018.

Këto projekte dhe aktivitete mbështeten në parimet e rëndësishme të kujtesës, që e vënë kujtesën historike në themel të identitetit dhe trashëgimisë së individëve e shoqërive dhe janë realizuar me përfshirjen dhe angazhimin e studiuesve e medias, me qëllim thellimin në faktet dhe të vërtetat e ish-Sigurimit të Shtetit në mënyrë shkencore.

Studimi i plotë dhe i thelluar i burimeve arkivore autentike të dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit është një proces i gjatë dhe i vazhdueshëm. Ai është mjeti i vetëm që do të garantojë rishqyrtimin e historisë së errët të strukturave dhe makinacioneve të përdorura nga regjimi komunist për më shumë se 45 vjet në Shqipëri, për shtypjen dhe persekutimin më të egër që ka njohur ndonjëherë historia e njerëzimit. Rishqyrtimi historik do të shërbejë si mjet për inkurajimin e dialogut social, në emër të transparencës dhe konsolidimit të demokracisë.

Projekte vjetore me partnerë

Programi ambicioz **“Përkujtojmë, për të shëruar dhe parandaluar”**, me mbështetjen e PNUD Shqipëri dhe Qeverisë së Italisë, përmblihte dy ndërhyrje kryesore:

1. konceptualizimin, historinë, dhe praktikat e punës së detyruar gjatë regjimit komunist përmes një qasjeje historiko-juridike ndaj institucionalizimit të punës së detyruar. Kjo kontribuoi në konceptimin e vendeve të kujtesës si Kampi i Tepelenës dhe (ii) fushatën e komunikimit **“Edhe muret kanë veshë”** zbatuar nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit. Fushata u shtri në mbarë vendin, duke mbledhur dëshmi të të mbijetuarve të dënuar gjatë periudhës komuniste dhe dëshmi të solidaritetit që qytetarët e Tepelenës treguan ndaj viktimave.
2. Projekti AIDSSH-PERFORM, për studimin e rolit të shkencës në zhvillimin e shoqërisë gjatë

viteve të para të vendosjes së regjimit komunist (1945-1954). Bashkoi punën kërkimore arkivore me informimin e publikut dhe ruajtjen e kujtesës historike, për nisjen e një dialogu publik mbi këtë temë. U studiuan në mënyrë multidisiplinore, 9 personalitete nga kërkues shkencorë dhe studentë. Rezultati përfundimtar i bashkëpunimit është krijimi i një platforme interaktive komunikimi në shqip dhe anglisht www.dosjet.gov.al, e arritshme në mënyrë elektronike nga publiku i gjerë, kryesisht të rinjtë. Botimi i kërkimeve shkencore mbi 9 personalitete të shkencës në dy gjuhë, me tekste që u flasin qartë të rinjve dhe materiale arkivore e foto ilustruese.

Aktivitete të organizuara në kuadër të kërkimit shkencor dhe edukimit qytetar

Më poshtë janë renditur nismat e ndërmarra dhe aktivitetet nëpërmjet të cilave, Autoriteti ka komunikuar me qytetarët dhe të interesuarit, sa u takon ngjarjeve përkujtimore apo personaliteteve historike:

Identifikimi i datave jubilarë, planifikimi i aktiviteteve për secilën prej tyre me qëllim sigurimin dhe vënien në dispozicion të materialeve përkatëse dokumentare për këto data;

Koordinimi me partnerët, shoqatat përkatëse, familjarët dhe komunitetin për secilin aktivitet;

Informimi me transparencë dhe edukimi qytetar nëpërmjet aktiviteteve që publikojnë dosje dhe

dokumente të personaliteteve, të ngjarjeve të caktuara historike-përkujtimore, duke i trajtuar ato në bazë të kërkimeve shkencore dhe rikrijimi i kuadrit historik;

Nënshkrimi i marrëveshjes me Muzeun “Gjethi” për realizim të aktiviteteve të përbashkëta, mes të cilave ekspozita dokumentare;

Nënshkrimi i marrëveshjes me Institutin e Historisë “Ali Hadri”, Prishtinë, bashkëpunim për projekte të përbashkëta, si konferenca për internim-dëbimet e të tjerë;



Ekspozimi në Tiranë dhe qytete të tjera të Shqipërisë i materialeve arkivore të AIDSSH-së, në bashkëpunim me partnerët, pushtetin lokal dhe komunitetin vendas. Informim e plotësim formularësh në çdo aktivitet.

Bashkëpunim me institucionin homolog në Çeki për përmirësimin e mënyrave të informimit të publikut mbi të shkuarën, të organizimit të ekspozitave, aplikacioneve dhe faqet online.

Njohje me dosjen e përndjekjes së poetit Trifon Xhagjika, vënie në dispozicion të studiuesve dhe publikim i detajeve të persekutimit.

Realizim i fushatave ndërgjegjësuese për të shkuarën, në bashkërendim me artistë bashkëkohorë, për të arritur në sa më shumë njerëz dhe breza të ndryshëm,





Fushata e komunikimit "Edhe muret kanë veshë"



Aktiviteti i AIDSSH në Konispol në bashkëpunim me komunitetin vendas

Fushata “Edhe muret kanë veshë” e dëshmime gojore, me takime në universitete, me intervista dhe emisione televizive, në kuadër të programit “Përkujtojmë për të shëruar dhe parandaluar”.

Takime të hapura në universitetet e Tiranës, Shkodrës, Durrësit, Korçës, Gjirokastrës, për temat e së kaluarës dhe informim mbi dosjet e ish-Sigurimit të Shtetit.

Realizimi i instalacionit artistik në sheshet kryesore të 6 qyteteve, Tiranës, Shkodrës, Beratit, Korçës, Tepelenës dhe Gjirokastrës, në bashkëpunim me partnerët dhe pushtetin lokal.

Krijimi i faqes online “Edhe muret kanë veshë”, në shqip dhe anglisht, që komunikon me shqiptarët brenda dhe jashtë vendit, përmes platformës së dëshmime gojore që rrëfejnë anën tjetër të përndjekjes së Sigurimit të Shtetit.

Aktivitetet Kampi N'dritë në Tepelenë më 23 gusht, me projekte artistike-sociale që i afrojnë të rinjtë dhe i njohin me të shkuarën.

Propozim Presidentit të Republikës për vlerësim me tituj nderi të figurave frymëzuese të internuara në kampin e Tepelenës, shembull i përndjekjes çnjerëzore dhe i përbaljes me dinjitet njerëzor.

Organizimi i workshopit “Raportimi mbi dosjet e ish-Sigurimit dhe kërkimi në arkiva”, në bashkëpunim me Institutin për Demokraci, Media dhe Kulturë. Informimi i të rinjve mbi plotësimin e formularëve për njohjen e ish-Sigurimit, me shembuj konkretë të punës në arkiva, analizës së materialeve dhe vizitë studimore në AIDSSH.

Shkëmbim përvoja në Yad Vashem, Izrael, mbi mënyrën si e trajtojmë kujtesën kolektive, impaktin e së shkuarës në shoqëri, rëndësinë për t’ua kaluar brezave dhe puna sistematike me të shkuarën.

Zhvillimi i konferencës së parë ndërkombëtare shkencore: “Të mohuar nga regjimi: burgjet, sistemi i internim-dëbimeve dhe puna e detyruar në Shqipërinë e viteve 1945-1990”, AIDSSH, në bashkëpunim me Institutin e Historisë, Institutin për Studimin e Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit dhe Institutin e Integritetit të ish-të Përndjekurve Politikë, në ndërveprim të gjerë me universitetet, partnerët vendas, rajonalë dhe të huaj.

Vendosja e emrit “Sabiha Kasimati” Muzeut të Shkencave të Natyrës, me propozim të AIDSSH. Ridimensionimi i figurës së shkencëtares, pas hapjes së dosjes, bërjes së njohur për komunitetin qytetar e

shkencor dhe botimi i një libri të plotë mbi figurën e saj. Krijimi i këndit të kujtesës “Sabiha Kasimati” në Muzeun e Shkencave të Natyrës, i hapur për qytetarët, me materiale historike dhe shkencore që e pasqyrojnë të plotë personalitetin e saj.

Realizimi i fletëpalosjeve dhe axhendës shkencore divulgative, me informacion të plotë për vizitorët e Muzeut.

Shfaqja e dokumentarit “Edhe muret kanë veshë”, që ilustron punën e bërë nëpër të gjithë vendin duke hapur dialog për të shkuarën përmes takimeve me qytetarë, atyre në universitete dhe finalizohet me instalacionin në 6 qytete.

Dokumentar mbi kampin e Tepelenës, i përgatitur me dëshmi të të mbijetuarve, materiale të siguruar nga



Aktiviteti i AIDSSH në Konispol në bashkëpunim me komunitetin vendas



Aktivitetet e zhvilluara në Tepelenë, më 23 gusht 2018

AIDSSH për publikun vendas dhe të huaj. Pasurimi i Wikipedias shqip me sa më shumë

informacion për personalitete dhe ngjarje historike që trajtohen në aktivitetet e Autoritetit. Institucionalizimi i marrëdhënieve të AIDSSH me

Federatën Panshqiptare “Vatra’ dhe Zërin e Amerikës për projektin e dëshmime gojore të komunitetit shqiptar të përndjekur në Shqipëri e SHBA nga Sigurimi i Shtetit. Informim i bashkësisë shqiptare atje dhe pasurim i arkivit të dëshmime gojore, i cili vihet në dispozicion të qytetarëve dhe kërkuesve shkencorë, krahas dosjeve të Sigurimit të Shtetit për ta.

Vënie në dispozicion e materialeve të kërkuara arkivore për realizimin e aktiviteteve të ndryshme që kanë në fokus të shkuarën, studiuësve dhe gazetarëve të shumtë, pjesëmarrës në të gjitha aktivitetet e Autoritetit.

Ekspozita dokumentare

Ekspozitat dokumentare janë një formë tjetër e rëndësishme e qasjes së AIDSSH-së në funksion të informimit mbi dokumente të ish-Sigurimit dhe edukimit qytetar. Ato janë organizuar duke paraqitur përpara qytetarëve dhe grupeve të interesit dokumente autentike arkivore sipas tematikave të përzgjedhura dhe duke asistuar me staf të specilizuar. Gjatë viti 2018 janë organizuar ekspozitat e mëposhtme dokumentare:


- -“45 vjetori i revoltës së Spaçit”, ekspozitë dokumentare me dosje/dokumente të krijuara nga ish-Sigurimi i Shtetit për repartin 313, Spaç, më 17 maj 2018. Dosjet u deklasifikuan dhe u bënë publike për herë të parë. Gjatë aktivitetit u bë informimi i qytetarëve si dhe u plotësuan formularë aplikimi për njohje me dosje.
- -Ekspozitë dokumentare me dosje/dokumente të krijuara nga ish-Sigurimi i Shtetit për zonën e Konispolit, më 13 qershor 2018. 40 dosje formulare, hetimore-gjyqësore dhe bashkëpunëtorësh u deklasifikuan dhe u bënë publike për herë të parë, për 46 viktima të evidentuara. Gjatë aktivitetit të zhvilluar në Tiranë, u bë informimi i qytetarëve si dhe u plotësuan formularë aplikimi për njohje me dosje.
- -“Persekutimi komunist në zonën e Konispolit”, në Konispol, më 26 qershor. 40 dosjet formulare, hetimore-gjyqësore dhe bashkëpunëtorësh të

deklasifikuara dhe të bëra publike për herë të parë në Tiranë, për 46 viktimat e evidentuara u ekspozuan për komunitetin vendas, në sheshin qendror të qytetit, në një organizim të posaçëm, në bashkëpunim me Bashkinë Konispol. Qytetarët u informuan gjatë aktivitetit dhe plotësuan formularë aplikimi për njohje me dosje.

- -Ekspozitë dokumentare me dosje/dokumente të krijuara nga ish-Sigurimi i Shtetit për zonën e Tepelenës, më 20 gusht 2018, në Tiranë, pranë AIDSSH, me prani të studiuësve, medias dhe shoqatave të të drejtave të njeriut. Në këtë aktivitet u deklasifikuan dhe u bënë publike për herë të parë 44 dosje. Dosjet e sigurimit trajtuan Kryengritjen e Zhapokikës, klerin vendas, kampin e Bënçës, të internuarit; të arratisurit, të vrarët në kufi, bandat e diversantëve e të tjera.
- -“Persekutimi komunist në zonën e Tepelenës”, në Tepelenë, më 23 gusht. Në këtë aktivitet u ekspozuan dokumentet dhe dosjet e sigurimit që dokumentonin persekutimin komunist të pjesëmarrësve në kryengritjen e Zhapokikës, klerit vendas, kampin e Bënçës, të internuarit; të arratisurit, të vrarët në kufi, bandat e diversantëve e të tjera me pjesëmarrjen e komunitetit vendas.
- -Ekspozita në Tiranë dhe Memaliaj e materialeve arkivore të AIDSSH, 5-6 tetor, për rezistencën antikomuniste të Zhapokikës, në bashkëpunim me institucionet homologe, pushtetin lokal dhe komunitetin vendas. Informim i qytetarëve dhe plotësim i formularëve në aktivitet.
- -Ekspozita “Mbi punën e STASI-t në DDR”, AIDSSH në bashkëpunim me Autoritetin Gjerman të Dosjeve dhe KAS, 22 tetor 2018, në kuadër të “Ditëve të Kujtesës”,.
- -Ekspozita “Mbikëqyr, terrorizo, përndiq” në gjimnazin “Petro Nini Luarasi”, bisedë me ish-të burgosur të Burrelit dhe paralelet mes dy realiteteve komuniste. Bashkëpunim i Autoritetit për Informimin

mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit dhe Inner Wheel Club Tirana, drejtësia tranzicionale për gjimnazet e Tiranës.

Botime



Publikimet në letër dhe online kanë qenë një formë tjetër e rëndësishme e përdorur nga AIDSSH për të përmbushur objektivat në lidhje me informimin dhe edukimin qytetar. Këto botime janë bazuar në tematika të përzgjedhura dhe janë realizuar mbi bazën e shqyrtimit dhe analizimit të të dhënave dhe fakteve të dokumentuara, kryesisht në dokumentet arkivore të ish-Sigurimit të Shtetit dhe burimeve të tjera arkivore që i përkasin të njëjtës periudhë, dëshmi të ish-të përndjekurve dhe të afërmeve të tyre. Në këto botime trajtohen në mënyrë shkencore figurat, personalitetet dhe ngjarjet historike. Më poshtë janë paraqitur botimet e realizuara për vitin 2018 nga AIDSSH.

- Raporti vjetor 2017 i AIDSSH-së (shqip dhe anglisht),

- Libri për grupin e deputetëve, në 70-vjetorin e dënimit,
- Libri për Sabiha Kasimatin,
- Axhendë shkencore pune, e bazuar mbi punën e shkencëtares Kasimati,
- Libri për grupin e “Kënetës së Maliqit”.
- Libri “Dëshmitë e të mbijetuarve në Kampin e Tepelenës”,
- Korniza juridike-historike e punës së detyruar në Shqipëri, 1944-1991, shqip dhe anglisht
- Buletinët 2-mujorë të vendimeve dhe veprimtarisë së Autoritetit për vitin 2018.

5.1.4 Siguria dhe Zhvillimi Teknologjik

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit gjatë veprimtarisë së tij është ndeshur me dokumente dhe informacione të klasifikuara dhe ka vepruar në përputhje me legjislacionin në fuqi për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”, sipas rastit dhe nivelit të klasifikimit.

Duke pasur parasysh se mbledhja, administrimi, përpunimi, përdorimi dhe informimi mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit udhëhiqet, ndër të tjera, edhe nga parimet e mbrojtjes së interesit publik dhe sigurisë kombëtare dhe mbrojtjes së të dhënave që përbëjnë informacion të klasifikuar, janë marrë masat për aq sa është e mundur, për garantimin e sigurisë të mjediseve, ruajtjen fizike të dokumentacionit arkivor, transportin e dokumenteve të klasifikuara sipas rastit pranë ambientit ku ushtron aktualisht veprimtarinë Autoriteti. Tashmë kemi një personel të trajnuar nga DSIK për aspekte të përgjithshme dhe të veçanta të punës me informacionin e klasifikuar, por jo vetëm, dhe në këtë kontekst, zbatimi i akteve nënligjore lidhur me hyrjen, daljen, regjistrimin, qarkullimin, administrimin e informacionit të klasifikuar ka qenë prioritet.

Gjithashtu, regjistrimi, administrimi, shfrytëzimi, shumëfishimi dhe arkivimi i të gjitha dokumenteve të klasifikuara që qarkullojnë brenda AIDSSH-së, bëhet sipas të njëjtave rregullave të sipërcituara me ato që

dërgohen nga Autoriteti dhe me ato që futen nga institucionet e tjera në Autoritet.

Kryesisht, shfrytëzimi i informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror” bëhet me qëllim ushtrimin e një detyre në bazë të parimit “nevojë për njohje”, me miratim të Kryetares apo Sekretarit të Përgjithshëm, vetëm nga persona të certifikuar përshtatshëm, të cilët ruajnë konfidencialitetin dhe autenticitetin e informacionit që përpunohet.

Me qëllim pasqyrimin dhe mundësinë e kontaktimit të AIDSSH-së në internet, faqja zyrtare [www. autoritetidosjeve.gov.al](http://www.autoritetidosjeve.gov.al) është e paraqitur në mënyrë të thjeshtë, e strukturuar nëpërmjet menuve dhe nënmenuve. Në të pasqyrohen informacione të përgjithshme mbi AIDSSH-në, Anëtarët e Autoritetit, kuadri ligjor i fushës së zbatimit, aktet nënligjore si dhe ligje të tjera ndihmëse. Ligjet dhe aktet nënligjore janë të gjitha në format të shkarkueshëm. Përveç këtyre, çdo ditë në faqe pasqyrohen informacione mbi aktivitetet e institucionit, njoftime për shtyp, konferenca shkencore, publikime për vende të lira pune, formularë për aplikime, materiale të përgatitura nga stafi, etj. Transparenca ndihmon në informimin e publikut, për të njohur dhe kuptuar më mirë zbatimin e ligjit nr. 45/2015 dhe aktet nënligjore të nxjerra në këtë drejtim.

Qëllimi është arritja te një numër sa më i madh qytetarësh-përdorues të faqeve tona online për marrjen e informacioni të plotë, si dhe sensibilizimi i tyre për t'u bërë pjesë e këtij procesi.

Edhe Muret Kanë Veshë, www.evenwallshaveears titullohet platforma e rrëfimeve të mbledhura nga AIDSSH. Kjo platformë komunikimi synon të rrisë ndërgjegjësimin mbi të kaluarën komuniste dhe të inkurajojë dialog mes universiteteve, studiuësve, komuniteteve lokale, të mbijetuarve të diktaturës dhe familjeve të tyre, medias e publikut të gjerë.

Projekti i dëshmimeve gojore është zgjeruar nga bashkëpunime të frytshme të Autoritetit me partnerë. Në dhjetor të 2018, u institucionalizua bashkëpunimi për mbledhjen e rrëfimeve të të përndjekurve nga diktatura komuniste në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me marrëveshjet me Zërin e Amerikës dhe

Federatën Panshqiptare Vatra.

Platforma Edhe Muret Kanë Veshë dhe libri i dëshmimeve, klikohen në faqen zyrtare të Autoritetit, e cila pasurohet në vijimësi. Dëshmitë janë pjesë e arkivit digjital të institucionit dhe ruhen me standarde bashkëkohore, krahas arkivit të dosjeve të Sigurimit të Shtetit.

Platforma ndërvepruese e komunikimit www.dosjet.gov.al dhe libri “Kur Sigurimi merrej me shkencë” prezantojnë mundësi të njohjes me informacionin mbi dosjet e Sigurimit nga të rinjtë, studiuesit apo të interesuarit e tjerë.

Nxjerrja në dritë e informacionit deri dje sekret dhe rikrijimi i kuadrit historik, nëpërmjet kërkimit të mbështetur shkencor, duke dhënë profilet e personaliteteve, duke ndërtuar kohështrirjen e jetës së secilit, duke e gërshetuar atë me tablonë historike, politike, ideologjike e shoqërore të kohës është hapi i parë. Intelktualët akademikë të dhjetëvjeçarit të parë të komunizmit do të pasohen nga profile të intelektualëve të dhjetëvjeçarëve pasues dhe tematika të tjera. Platforma do të pasurohet në vijim me informacion mbi Sigurimin e Shtetit, të vendosur gjithnjë në kontekst historik, duke qenë e aksesueshme për të gjithë, shqiptarë e të huaj dhe e dobishme në disa nivele njohjeje.

Në ndihmë të marrjes së informacionit rreth interesit të qytetarëve për informimin mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit në faqen zyrtare [http:// autoritetidosjeve.gov.al/](http://autoritetidosjeve.gov.al/) shërbejnë statistikave e vizitorëve të faqes, të cilat mundësohen nga Google. Në këtë kuadër, hartohen raporte mujore bazuar në këto statistika, të cilat mund të jenë të përgjithshme apo të bazuara në shtete/qytete, grupmosha, gjini, gjuhë, seksione të ndryshme të faqes, etj.

Në funksion të përmirësimit cilësor të punës dhe në konsiderim të futjes në përdorim të teknologjive të reja e të fundit, si një nga momentet më thelbësore të vitit 2018 është instalimi dhe konfigurimi i serverit, së bashku me active directory, ku bëhet e mundur ruajtja e dokumentacionit të institucionit si dhe pajisja me sharefolder e çdo punonjësi.

Përveç pjesës teknike dhe problematikave që lidhen

me infrastrukturën e institucionit, është punuar edhe me disa projekte të rëndësishme, si:

Projekti AIDSSH-PERFORM (Sigurimi dhe Shkenca), për studimin e rolit të shkencës në zhvillimin e shoqërisë gjatë viteve të para të vendosjes së regjimit komunist (1945-1954), me platformën ndërvepruese të komunikimit www.dosjet.gov.al.

Projekti “Përkujtojmë për të shëruar dhe parandaluar” ka mbështetur platformën online “Edhe muret kanë veshë”, në shqip dhe anglisht, që komunikon me shqiptarët brenda dhe jashtë vendit përmes dëshmive gojore, të cilat rrëfejnë anën tjetër të përndjekjes së Sigurimit të Shtetit, si dhe publikohen online për të gjithë të interesuarit e kërkuesit shkencorë. Kjo platformë po pasurohet me dëshmi të reja në vazhdimësi, gjithashtu bëhet përditësimi dhe editimi i disa rubrikave, sipas nevojës dhe kërkesave të institucionit.

Në vijim të saj, në 2018 AIDSSH bashkëpunoi me Ambasadën Gjermane për projektin e dëshmive gojore dhe arkivin digjital të dëshmive. Në këtë kuadër, janë mundësuar pajisjet e nevojshme për të realizuar procesin e marrjes dhe regjistrimit të dëshmive gojore.

Ndërtimi i Sistemit të Menaxhimit të Çështjeve (Case Management System)

Ky sistem ka për qëllim të menaxhojë dhe automatizojë operacionet e AIDSSH-së, duke mbështetur çdo kërkesë drejtuar Autoritetit nga qytetarë, Qeveria ose institucionet e pavarura, mediat, hulumtuesit, etj. Ka filluar puna për hartimin e projektit me të gjitha specifikimet teknike, për të vijuar më tej me implementimin dhe zhvillimin e sistemit.

Ngritja e sistemit të arkivit digjital

Arkivi digjital mundëson menaxhimin e të dhënave, indeksimin dhe ruajtjen digjitale të tyre, si dhe do të mbështesë proceset tipike të punës, duke nisur nga para-arkivimi, transferimi dhe procesimi i të dhënave, deri te ruajtja dhe kërkimi i tyre.

Po punohet mbi përcaktimin e të gjitha nevojave teknike

rreth këtij sistemi dhe synohet zhvillimi i një sistemi të mirëfilltë arkivor që do të organizojë dhe lehtësojë proceset e punës në institucion.

Blogu “Muze Memorial Tepelenë” <https://muzememorialtepelene.wordpress.com>, ka publikuar të dhëna dhe materiale të ndryshme, si foto dhe video rreth Kampit të Tepelenës. Ky blog mirëmbahet, pasurohet dhe përditësohet në varësi të të dhënave. Përveç blogut, është menduar ndërtimi i një uebi të mirëfilltë, për të cilën synohet një faqe interaktive, sëbashku me krijimin e një muzeu virtual.

Përdorimi i platformës online ISSUU për publikimin e të gjithë librave dhe botimeve të AIDSSH-së. Është krijuar profili i institucionit tonë në këtë platformë dhe vazhdon publikimi për çdo artikull të ri që botohet.

5.1.5 Mbi problematikat e ndeshura në veprimtarinë e AIDSSH-së me qëllim gjetjen e rrugëve më efikase për zgjidhjen e tyre nga Kuvendi dhe Këshilli i Ministrave

Veprimtaria e AIDSSH-së, në bazë të ligjit organik 45/2015, “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë” dhe akteve të tjera ligjore që normojnë funksionimin e institucionit, siç edhe rezulton më sipër, është fokusuar në tre drejtime kryesore:

Së pari, aksesimi i çdo qytetari në dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit sipas ligjit 45/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit” dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

Së dyti, vlerësimi i cilësive etike, morale dhe profesionale të kandidatëve/zyrtarëve përpara emërimit apo ngritjes në detyrë, kur kjo kërkohet nga institucionet kushtetuese dhe autoritetet publike, sipas një hierarkie të parashikuar në ligj, si dhe të gjithë të zgjedhurve nga populli, deputetë dhe të zgjedhur vendorë;

Së treti, krijimi i infrastrukturës së duhur për mundësimin e kërkimit shkencor dhe informimin e medias mbi

veprimtarinë dhe historikun e ish-Sigurimit të Shtetit.

Në funksion të realizimit të detyrimeve ligjore të renditura më lart, AIDSSH ka marrë në administrim gjithë dokumentet e krijuara nga ish-Sigurimi i Shtetit, që janë disa qindra mijëra dosje mbi 2.2 km dokumente, ku rreth 70% e tyre përbëjnë sekret shtetëror dhe kërkojnë administrim, ruajtje dhe qarkullim sipas ligjit për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror” dhe akteve të tjera nënligjore. Për këtë arsye, gjithë stafi i AIDSSH-së ka detyrimin ligjor të pajiset me certifikatë sigurie.

Aktualisht, dokumentet arkivore, megjithëse ka përfunduar procesi i marrjes në dorëzim, sipas VKM nr. 98/2017 “Për përcaktimin e procedurës së kalimit nën administrimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të materialeve arkivore të ish-Sigurimit të Shtetit, që gjenden në Ministrinë e Mbrojtjes, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Shërbimin Informativ të Shtetit dhe në autoritetet e tjera publike”, fizikisht vazhdojnë të jenë në ambientet e SHISH-it dhe Ministrisë së Brendshme, duke krijuar vështirësi serioze deri në cenim të pavarësisë së institucionit tonë.

Tregues kryesorë të fluksit të punës së deritanishme të AIDSSH-së:

- Kërkesa individuale rreth 1000, për rreth 700 prej tyre ka përfunduar procesi.
- Produkt i kërkesave institucionale, 1300 zyrtarë të verifikuar për dhënien e informacionit mbi ekzistencën e dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit.
- Rreth 200 kërkesa nga studiues dhe media. Janë shërbyer qindra dosje dhe janë digjitalizuar mbi 150 mijë faqe dokumente.
- Që nga krijimi e deri më sot, në adresë të Autoritetit janë paraqitur rreth 80 kërkesa me objekt rehabilitimin dhe qartësimin e fatit të vdekurve apo të të zhdukurve, pjesa më e madhe të përfunduara,

në proces verifikimi 22 kërkesa.

- Gjatë vitit 2019, për shkak të ligjit të vettingut në Policinë e Shtetit dhe për faktin që është vit zgjedhor, pritet dhjetëfishim i punës së Autoritetit.

Fondi i vënë në dispozicion institucionit tonë nga Qeveria është 2 milionë lekë për investime. Ndërkohë, sipas projektit të hartuar nga Instituti i Ndërtimit, vetëm për lotin e parë të investimeve, që përfshin mjediset arkivore dhe infrastrukturën hidraulike e elektrike duhen 30 milionë lekë. Duke qenë se një pjesë e këtij fondi prej 10 milionë lekësh u akorduan gjatë gjysmës së dytë të vitit të kaluar, mbetet imediate mbështetja nga buxheti i shtetit edhe me 18 milionë lekë për përfundimin e lotit të parë. Edhe sinjali pozitiv që është dhënë nga donatorët suedezë për rikonstruksionin total të godinës kushtëzohet nga përfundimi i lotit të parë.

Krijimi i kushteve optimale për ushtrimin e veprimtarisë së AIDSSH-së është përgjegjësi e Qeverisë dhe nëse do të konsiderojmë faktorët që sjellin riskun e lartë fizik dhe sigurinë që mbart në vetvete fondi arkivor i shpërndarë në institucione të ndryshme, përfshirë këtu mungesën e kushteve fizike optimale, temperaturat e larta që ndikojnë negativisht në ruajtjen e dokumenteve arkivore, dhe mungesën e eficiencës në punë të administratës së AIDSSH-së gjatë procesit të administrimit të dokumentacionit arkivor të kërkuar nga subjektet e parashikuara nga zbatimi i ligjit 45/2015, e bën mëse të domosdoshme ndërhyrjen urgjente të Qeverisë në dhënien e fondeve përkatëse AIDSSH-së për rikonstruksionin e godinës së re.

Duke vlerësuar maksimalisht bashkëpunimin me Kuvendin e Shqipërisë dhe duke shpresuar realisht në adresimin dhe zgjidhjen e problemeve, më poshtë po pasqyrojmë shqetësimet dhe nevojat tona prioritare, për mirëfunksionimin e institucionit.

Shprehim shqetësimet tona për buxhet të cunuar si për vitin 2019, edhe në Projekt Buxhetin Afatmesëm 2019-2021, ku shpenzimet për paga dhe investime

nuk na krijojnë kushtet e nevojshme të punës, kur ndodhemi përpara një situatë me numër të shtuar të kërkesave individuale, institucionale dhe nga studiues/media gjatë vitit 2018 dhe trendin në rritje të këtyre kërkesave në fillimin e vitit 2019, duke përmendur që ky është viti i zgjedhjeve për pushtetin vendor.

Rikujtojmë detyrimin e Qeverisë për të plotësuar kushtet e punës për plotësimin e strukturës dhe fonde për investime në zbatim të ligjit organik 45/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”, neni 7, pika 6, ku thuhet “Autoriteti, me kërkesën e tij, pajiset nga Këshilli i Ministrave me mjedise dhe i krijohen kushtet e nevojshme të punës”. Sa më sipër,

1. Është imediat respektimi i Vendimit nr. 95/2016 të Kuvendit të Shqipërisë “Mbi miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimin e pagave të Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish Sigurimit të Shtetit”, aktualisht nga 60 (gjashtëdhjetë) punonjës që duhet të ishin, Qeveria ka mbështetur në ligjin e buxhetit vetëm 50% të strukturë/organikës së AIDSSH-së.

Përveç kësaj, punonjësit e arkivit të AIDSSH-së, sektor që mban vend të rëndësishëm në Autoritet, pasi ka të bëjë drejtpërdrejt me dosjet dhe dokumentet arkivore, të përfitojnë shtesë në pagë për kushtet e vështira e të dëmshme për shëndetin, shtesë të cilën sipas VKM nr. 187, datë 08.03.2017, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, Zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Gjykatën e Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e Prefektit (1)(2)”, i ndryshuar, e përfitojnë disa kategori të tjera të sistemit arkivor në Republikën e Shqipërisë, si psh. citojmë VKM-në: *“Përfitojnë një shtesë për kushte*

të vështira e të dëmshme për shëndetin nëpunësit në pozicionet: - “Përgjegjës i Sektorit të Arkivit” dhe “Specialist Arkivi”, në Kryeministri, Presidencë, Kuvend, aparatet e ministrive të linjës, si dhe në pozicionet “Përgjegjës Sektori” dhe “Specialist” në drejtoritë apo sektorët e përmbajtjes në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave dhe drejtoritë rajonale/vendore të sistemit të arkivave të shtetit”.

Në këto kushte, është i nevojshëm ndryshimi i VKM 187, datë 8/3/2018, në mënyrë që punonjësit e arkivit të AIDSSH-së, të përfitojnë shtesën për kushte të vështira dhe të dëmshme për shëndetin.

2. Është emergjente vënia në dispozicion e fondit për rikonstruksionin e godinës së re, pasi aktualisht, e gjithë veprimtaria e AIDSSH-së zhvillohet në zyra të përkohshme të Garda e Republikës, pa standarde minimale zyrtare. Për më tepër, dokumentet arkivore, megjithëse ka përfunduar procesi i kalimit nën administrim, sipas VKM nr. 98/2017 “Për përcaktimin e procedurës së kalimit nën administrimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të materialeve arkivore të ish-Sigurimit të Shtetit, që gjenden në Ministrinë e Mbrojtjes, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Shërbimin Informativ të Shtetit dhe në autoritetet e tjera publike”, fizikisht vazhdojnë të jenë në ambientet e SHISH-it dhe Ministrisë së Brendshme, duke krijuar vështirësi serioze deri në cenim të pavarësisë së institucionit.
3. Është në të mirën e punës së funksionimit me përbërje të plotë të Anëtarësisë së Autoritetit, zhvillimi i procedurave të nisura nga Kuvendi për zëvendësimin e një prej anëtarëve të Autoritetit, i cili ka mëse një vit që ka dhënë dorëheqjen dhe ende nuk kanë përfunduar procedurat, fakt ky që vështirëson vendimarrjen kolegjiale të institucionit.

Mbetemi shpresëplotë se bashkëpunimi dhe koordinimi me strukturat e Kuvendit të Shqipërisë do të shërbejë

në adresimin dhe zgjidhjen e problemeve të renditura më lart, që do të krijojnë mundësinë e funksionimit normal të punës, por në të njëjtën kohë, na vendos përpara detyra të rëndësishme, që të gjithë bashkë duhet të realizojmë për përmbushjen me sukses të misionit të AIDSSH-së.

5.2 Objektivat e institucionit për vitin 2019

Objektivat kryesorë të Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit për vitin 2019 mbështeten në Planin Strategjik 2017-2020 dhe grupohen në disa kategori kryesore:

1. Objektiva që kanë të bëjnë me përmirësimin e infrastrukturës dhe rritjen e kapaciteteve administrative

- Përfundimi i rikonstruksionit të godinës sipas projektit të hartuar nga Instituti i Ndërtimit, dhe pajisja e tij me rafte dhe facilitete të tjera, të domosdoshme për arkivin;
- Vazhdimi i bashkëpunimit me të gjitha institucionet partnere vendase e të huaja, si dhe vendosja e kontakteve me partnerë të rinj, në funksion të përmirësimit të infrastrukturës dhe rritjes së kapaciteteve administrative.

2. Objektiva që kanë të bëjnë me themelimin e Autoritetit si burim arkivor qendror për kërkime mbi aktivitetet e Sigurimit

- Përfundimi i procesit të marrjes në dorëzim të të gjitha dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit nga institucionet arkivore në vend;
- Hartimi i planit të transferimit të dokumenteve arkivore në godinën e re dhe transferimi i tyre në godinën e re sipas planit të miratuar;
- Krijimi i sistemit të arkivit digjital, i cili do të lehtësojë procesin e kërkimit dhe konsultimit me dokumentet arkivore.

3. Objektiva që kanë të bëjnë me sigurimin e së drejtës për informim mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit

- Rishikimi dhe përmirësimi i procedurave të brendshme për trajtimin e kërkesave individuale, institucionale dhe studimore;
- Përmbyllja brenda afateve, për aq sa është e mundur, e të gjitha kërkesave për informim mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, të paraqitura pranë AIDSSH-së.

4. Objektiva që kanë të bëjnë me nxitjen e kërkimit shkencor dhe edukimit qytetar

- Përfundimi dhe miratimi i strategjisë së komunikimit;
- Organizimi i veprimtarive sipas planit të miratuar;
- Vazhdimi i projekteve të nisura gjatë vitit 2018.

5. Objektiva që kanë të bëjnë me promovimin e transparencës dhe drejtësisë tranzicionale

- Mbështetja e punës së dokumentimit të krimeve të komunizmit, përfshirë kontributi në bërjen e drejtësisë.
- Bashkëpunimi me institucionet dhe aktorë të tjerë në fushën e drejtësisë tranzicionale.

6. Objektivat që kanë të bëjnë me menaxhimin

- Themelimi i Autoritetit si një trupë profesionale;
- Përmirësimi i angazhimit, zhvillimit dhe produktivitetit të punonjësve;
- Përdorimi i aseteve për ndërtimin e partneriteteve dhe burimeve.

Në mënyrë më të detajuar, këto objektiva janë zbërthyer në Planin e punës për vitin 2019, sipas drejtorive

përkatëse. AIDSSH do të vijojë punën në zbatimin korrekt dhe profesional të detyrave funksionale e bazës ligjore përkatëse, si dhe rritjes e forcimit të kapaciteteve të burimeve njerëzore, nëpërmjet bashkëpunimeve e trajnimeve brenda dhe jashtë vendit në institucionet homologe apo të kujtesës.

5.3 Synimet për të ardhmen

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit udhëhiqet nga misioni i tij ligjor për dhënien e informacionit mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (si dhe Rezoluta e Parlamentit Europian të 2 Prillit 2009, mbi ndërgjegjen dhe totalitarizmin).

Vizioni i Autoritetit është të sigurojë një platformë të besueshme, për të aksesuar trashëgiminë e madhe dokumentare të ish-Sigurimit të Shtetit; angazhimi i qytetarëve shqiptarë të të gjitha prejardhjeve duke siguruar të dhëna, informacion dhe kontekst nga arkivat e Sigurimit mbi përvojën e shtypjes komuniste; të shërbejë si burim i arritshëm dhe jetik për të vlerësuar eksperiencën shqiptare në komunizëm, në mënyrë që ajo të mos përsëritet në të ardhmen.

Duke dhënë informacion mbi aktivitetet e Sigurimit, Autoriteti synon të rrisë ndërgjegjësimin e publikut për regjimin komunist, që të ndihmojë në parandalimin e jotolerancës, ekstremizmit, lëvizjeve antidemokratike dhe përsëritjen e sundimit totalitar; të inkurajojë një diskutim të hapur për të kaluarën komuniste dhe pasojat e saj, bazuar në transparencë, integritet, bashkëpunim me individë dhe institucione dhe inkurajojë angazhimin publik, duke mbështetur vlerat demokratike të drejtësisë, të vërtetës dhe përgjegjësisë për gjeneratat e ardhshme.

Dokumenti i Strategjisë për vitet 2017-2020 shërben si dokument udhëzues për veprimtarinë e Autoritetit dhe ka për qëllim të drejtë dhe përqendrojnë aktivitetet e tij, duke mundësuar gjithashtu rishikime periodike të qëllimeve dhe objektivave.

Synimet për të ardhmen bazohen në vizionin e institucionit, realizimin e misionit të tij, dhe përmbushjen e objektivave strategjike të përmendur më sipër.

5.4 Parashikimi trevjeçar në lidhje me vizionin e institucionit

Vizioni i AIDSSH-së në trevjeçarin e ardhshëm konsiston në:

Përmirësimin e kuadrit ligjor ekzistues;

Plotësimin e strukturë/organikës së AIDSSH-së;

Ngritjen e infrastrukturës ligjore dhe logjistike në procesin e transferimit të dokumentacionit të disponueshëm nga AIDSSH, nga vendruajtjet aktuale në godinën e re të Autoritetit;

Realizimin e dy konferencave në vit dhe dy dialogëve lokalë;

Indeksimin digjital të dokumentacionit të administruar nga ana jonë;

Deklasifikimin në total të dosjeve, duke përjashtuar ato që cenojnë sigurinë kombëtare;

Zhvillimin e procedurave ligjore për trajtimin dhe përmbylljen e 1000 kërkesave në vit;

Shkurtimin e afateve kohore të shërbimit të dokumentacionit, në funksion të përgjigjes së kërkesave të paraqitura nga subjektet e interesuara;

Ueb funksional www.dosjet.gov.al, po ashtu dhe për burgjet e kampet e internimeve në vend.

Autoriteti synon të jetë një organ profesional efektiv, me personel të angazhuar dhe të kualifikuar, të aftë për të vendosur partneritete me homologë vendas dhe ndërkombëtarë.

06

**NDRYSHIMET NË KUADRIN
RREGULLATOR PËR VITIN 2018
DHE EFEKTET E TYRE**

AIDSSH ka miratuar disa urdhra me afat 1-vjeçar për vitin 2018, të cilët rregullojnë punën në sektorin e prokurimeve, si më poshtë:

Urdhër për krijimin e Komisionit të Prokurimit me Vlerë të Vogël;

Urdhër për krijimin e Komisionit të Testimit të Tregut dhe Përlogaritje e Fondit Limit;

Urdhër për krijimin e Komisionit të Sistemit Dinamik të Biletave të Transportit Ajror Ndërkombëtar;

Urdhër për caktimin e Personit Përgjegjës të Prokurimit;

Urdhër për krijimin e Komisionit të Marrjes në Dorëzim të Mallit;

Shkresë për Përcaktimin e Nëpunësit të autorizuar të Komisionit të Prokurimit me Vlerë të Vogël që do të kryejë veprimet në SPE;

Urdhër për caktimin e Personit Përgjegjës të Autoritetit kontraktor për procedurën e prokurimit të klasifikuar;

Urdhër për ngritjen e njësisë së prokurimit për zhvillimin e procedurës për prokurimin me objekt "Mbikëqyrja e punimeve për "Rikonstruksionin dhe përshtatjen e Arkivit të Godinës së re të Autoritetit";

Urdhër për ngritjen e njësisë së prokurimit për zhvillimin e procedurës për prokurimin me objekt "Rikonstruksioni dhe përshtatja e Arkivit të Godinës së re të Autoritetit" Gjithashtu, është ngritur njësia e prokurimit për zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt: Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, duke filluar me ngritjen e njësisë së prokurimit për zhvillimin e procedurës për prokurimin e punëve me objekt "Rikonstruksioni dhe përshtatja e Arkivit të Godinës së re të Autoritetit", fondi limit i miratuar për vitin 2018 është vlera 9.876.891,23 (nëntë milion tetëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë tetëqind e nëntëdhjetë e një, presje njëzet e tre) lekë pa TVSH, vënë në dispozicion nga buxheti i shtetit, në zbatim të aktit normativ nr. 1, datë 26.07.2018, "Për disa ndryshime në Ligjin nr.109/2017 "Për buxhetin e vitit 2018", urdhrin e prokurimit, hartimin e procesverbaleve për miratimin e dokumenteve standarde, përcaktimin e operatorëve ekonomikë, ftesat për pjesëmarrje për secilën procedurë dhe që do të vijojë me Manualin e Sigurisë dhe çdo dokument të nevojshëm, deri në

përfundim të tyre.

Njëkohësisht, është ngritur njësia e prokurimit për zhvillimin e procedurës e prokurimit me objekt "Mbikëqyrja e punimeve për "Rikonstruksionin dhe përshtatjen e Arkivit të Godinës së re të Autoritetit", fondi limit i miratuar për vitin 2018 është vlera 111.472 (njëqind e njëmbëdhjetë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e dy) lekë pa TVSH, vënë në dispozicion nga buxheti i shtetit, në zbatim të aktit normativ nr. 1, datë 26.07.2018, "Për disa ndryshime në ligjin nr.109/2017 "Për buxhetin e vitit 2018". Në këtë drejtim, mbi bazën e urdhrin të prokurimit janë draftuar procesverbalet për miratimin e dokumenteve standarde, janë përcaktuar operatorët ekonomikë, ftesat për pjesëmarrje për secilën procedurë dhe që do të vijojë me Manualin e Sigurisë dhe çdo dokument të nevojshëm, deri në përfundim të kësaj procedure.

Urdhra të tjerë rregullatorë të punës në Sektorin Juridik dhe të Prokurimeve:

Ndryshim i Urdhrit për përbërjen e Autoritetit Përgjegjës në parandalimin, kontrollin dhe zgjidhjen e gjendjeve të konfliktit të interesave (ILDKPI);

Urdhër për Raportimin periodik të veprimtarisë së Institucionit (realizimet). Hartuar Urdhri, vënë në dispozicion për zbatim;

Janë miratuar me vendime të Autoritetit disa akte, si më poshtë:

Me Vendimin e Autoritetit nr. 17, datë 11.01.2018 është miratuar Struktura e Shpenzimeve Buxhetore për vitin 2018 të Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.

Me Vendimin e Autoritetit nr. 28, datë 26.01.2018 është miratuar Plani vjetor i veprimtarisë për vitin 2018 të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.

Me Vendimin e Autoritetit nr. 29, datë 26.01.2018 është miratuar Plani vjetor i rekrutimeve për vitin 2018 të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.

Me Vendimin e Autoritetit nr. 43, datë 13.02.2018 është miratuar Ngritja e Komisionit për inventarizimin, përpunimin, hartimin e listës me bazë të dhënash të

dokumentacionit arkivor të krijuar nga Komisioni që ka funksionuar sipas ligjit nr. 8001, datë 22.9.1995, “Për gjenocidin dhe krimet kundër njerëzimit kryer në Shqipëri gjatë sundimit komunist për motive politike, ideologjike dhe fetare”, të ndryshuar, si dhe ligjit nr. 8043, datë 30.11.1995, “Për kontrollin e figurës së zyrtarëve dhe personave të tjerë që lidhen me mbrojtjen e shtetit demokratik”, të ndryshuar.

Me Vendimin e Autoritetit nr. 371, datë 24.10.2018 janë rialokuar fondet brenda buxhetit të vitit 2018.

Me vendimet e Autoritetit nr. 392, datë 25.10.2018 dhe nr. 448, datë 18.12.2018 është miratuar ndryshimi i Planit vjetor të rekrutimeve për vitin 2018 të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.

Me Vendimin e Autoritetit nr. 449, datë 18.12.2018 është miratuar “Kodi i Sjelljes së mirë administrative” për punonjësit e AIDSSH.

Me Vendimin e Autoritetit nr. 450, datë 18.12.2018 është miratuar “Kodi i Sjelljes për Anëtarët e AIDSSH. Në zbatim të nenit 25 të ligjit nr.45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish- Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, edhe gjatë vitit 2018 është punuar me pasqyrimin e sugjerimeve dhe përmirësimin e projektvendimit “Për Përcaktimin e Tarifave dhe Pagesave për Shërbimet ndaj Institucioneve apo Personave që ofrohen nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit”. Projektvendimi është dërguar zyrtarisht për mendim në Ministrinë e Financave, duke pasur parasysh se në të parashikohen edhe kosto financiare për subjektet e përfshira në të.

Pas një korrespondence të gjatë zyrtare është finalizuar varianti përfundimtar, pas përfshirjes edhe të sugjerimeve të institucioneve/ministrive të përfshira në këtë proces dhe aktualisht, është miratuar nga Këshilli i Ministrave Vendimi “Për Përcaktimin e Tarifave dhe Pagesave për Shërbimet ndaj Institucioneve apo Personave, që ofrohen nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”, sipas kërkesave të nenit 43 të ligjit nr. 45/2015.

Siç u tha më sipër, është përmirësuar formulari për

kërkesat nga institucionet kushtetuese apo autoritetet publike, proces që është finalizuar me përgatitjen e formularit të ri, i cili është legjitimuar dhe miratuar nga Autoriteti me Vendimin nr. 178, datë 22.06.2018.

07

**TË DHËNA DHE SHIFRA MBI
AKTIVITETIN E AIDSSH-SË TË
KRAHASUARA ME VITIN 2017**

Më poshtë janë paraqitur në mënyrë të grafike të dhënat lidhur me aktivitetin e institucionit, sipas specifikave të drejtorive përkatëse:

Digjitalizimi dhe deklasifikimi i dokumenteve arkivore

Të dy proceset, digjitalizimi dhe deklasifikimi i dokumenteve gjatë vitit 2018 kanë rezultuar me rritje të konsiderueshme të numrit të dokumenteve të digjitalizuara dhe dokumenteve të deklasifikuara. Grafiku më poshtë tregon të dhënat krahasuese, të realizuara për të dy proceset gjatë vitit 2017 dhe 2018.




Figura: Dokumentet e digjitalizuara dhe deklasifikuara gjatë vitit 2017 dhe 2018

Kërkesat për informim mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit




Figura: Paraqitja grafike e numrit të kërkesave, të ndara sipas vitit 2017 dhe 2018

Gjatë vitit 2018 ka pasur rritje të konsiderueshme të numrin të kërkesave të ardhura në adresë të AIDSSH-së. Kjo rritje vërehet pothuajse në të gjitha tipet e kërkesave, por më së shumti në kërkesat individuale dhe kërkesat studimore. Më poshtë janë paraqitur në formë grafike të dhënat e numrit të kërkesave të ardhura gjatë dy viteve të fundit, të ndara sipas llojit të kërkesave dhe më pas, për çdo lloj kërkesë është paraqitur ecuria e trajtimit të tyre përgjatë secilit vit.




Figura: Paraqitja grafike e kërkesave individuale, sipas statusit të tyre për vitet 2017 dhe 2018




Figura: Paraqitja grafike e kërkesave individuale për qëllime rehabilitimi, 2017 dhe 2018

Gjatë dy viteve, 2017 dhe 2018, kanë kaluar filtrin 1284 kandidatë apo zyrtarë, përpara emërimit apo ngritjes në detyrë, nga të cilët, 1254 figura kanë rezultuar pa probleme dhe 30 kandidatë rezultojnë të figurojnë në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit ose bashkëpunëtorë.




Figura: Paraqitja grafike e kandidatëve dhe zyrtarëve të verifikuar gjatë viteve 2017 dhe 2018

08

**VLERËSIMI PËR NIVELIN E
ZBATIMIT TË DETYRIMEVE
LIGJORE NGA AIDSSH DHE
PËRGJEGJËSITË NË RASTET
KUR LIGJI ËSHTË SHKELUR
APO NUK ËSHTË
KONSIDERUAR**

Në komunikim aktiv me publikun dhe të interesuarit për realizimin e detyrave funksionale, drejtoria e informacionit në AIDSSH është udhëhequr nga parimi i ligjshmërisë, mbrojtjes së të dhënave personale, dhënies së informacionit publikut, institucioneve dhe medias në kohë dhe me cilësi. Në përmbushje të detyrimeve ligjore, nuk ka pasur raste të tejkalimit apo keqpërdorimit të kompetencave në ushtrimin e funksioneve për të cilat ligji nr. 45/2015 dhe Rregullorja e Brendshme e AIDSSH e ngarkojnë.

09

**STATUSI NË ZBATIM TË
REKOMANDIMEVE QË
INSTITUCIONE TË TJERA
KUSHTETUESE OSE TË
PAVARURA KANË DHËNË PËR
AIDSSH-NË**

Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, me qëllim për të lehtësuar procedurat për mbledhjen, administrimin, përpunimin, përdorimin e dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit dhe informimin me këto dokumente arkivore të subjekteve që parashikon ligji, në fund të vitit 2018 ka zhvilluar takime pune me zyrën e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, lidhur me përgatitjen e draftit të rregullores “Mbi publikimin e veprimtarisë së Autoritetit në ushtrim të detyrave funksionale të ngarkuara me ligj”, e materializuar kjo me vendimin nr. 88, datë 22.02.2019 për miratimin e saj, pasi më parë është marrë miratimi paraprak nga Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Drejtorja e sigurimit të informacionit të klasifikuar, në maj 2018, nëpërmjet Raportit të Inspektimit për marrjen e masave lidhur me zbatimin e kërkesave të sigurisë në fushën e sigurimit të informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror” që trajtohet në sistemet e komunikimit dhe informacionit”, dhe në qershor 2018, “Për sigurimin e informacionit të klasifikuar në fushën industriale dhe zbatimin e kërkesave të Instruksionit të Sigurisë së Projektit (ISP), i ka rekomanduar Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit:

- të hartojë dokumentet e sigurisë për pajisjet/sistemet, në funksion të paraqitjes së këtij dokumentacioni për shqyrtim në DSIK,
- marrjen e masave përkatëse, që informacioni dhe dokumentet e klasifikuara për prokurimin e klasifikuar të përpunohen vetëm në pajisje, sisteme apo rrjet informatik të certifikuar/akredituar përshtatshëm, sipas kërkesave të legjislativitetit në fuqi.

Për sa na rekomandohet nga DSIK, Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, me vendimin nr. 287 datë 04.09.2018, vendosi të informojë DSIK-në, lidhur me miratimin e dokumentacionit të paraqitur si më poshtë:

- Plan veprimi “Siguria e pajisjeve hardware”;
- Plan veprimi “Raportimi i incidenteve të sigurisë së sistemit të klasifikuar”;
- Plan veprimi “Implementimi i masave të sigurisë në sistemet e klasifikuara”;
- “Procedurat e operimit të sigurt”;
- Deklarata e sigurisë, si dhe
- dërgimi e dokumentacionit të sipërcituar për shqyrtim DSIK-së.
- Sa më sipër, në shtator të vitit 2018, DSIK paraqiti aktvlerësimin për certifikimin e kompjuterit standalone të klasifikuar të Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, e shoqëruar kjo me lëshimin e Certifikatës së sigurisë së sistemit nr. 022.

Në këto kushte, çdo dokument prodhohet në sistem standalone të akredituar nga DSIK me nivel “sekret”, e vlefshme deri në datë 19.09.2020 sipas certifikatës nr. 022, lëshuar nga autoriteti akreditues (DSIK). Sistemi standalone i Autoritetit është sistem i mbyllur, duke siguruar integritetin. Përdoruesit janë të pajisur me certifikatë të sigurimit të personelit të përshtatshme, janë njohur me procedurat e Operimit të Sigurt, trajnohen nga strukturat përgjegjëse, çka siguron se janë të ndërgjegjësuar me problematikat e sigurisë së informacionit të klasifikuar. Politikat e sigurisë të implementuara në sistem, si dhe procedurat që ndiqen janë të tilla që përdoruesit të kenë akses në sistem, në përputhje me parimin “nevojë për njohje”.

Gjithashtu, vlerë të shtuar ka marrë projekti i godinës së re, për sa i takon hartimit të dokumenteve të tenderit dhe zbatimit me përpikëri të projektit, sipas rekomandimeve të DSIK, në funksion të vendosjes së parametrave dhe mjeteve të kërkuara, sipas vendosjes së zonave përkatëse të sigurisë.

10

**NEVOJA PËR NDRYSHIME NË
KUADRIN LIGJOR QË
RREGULLON VEPRIMTARINË
E AIDSSH-SË**

10.1 Ndryshime të mundshme në ligjin 23/2015, “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”.

Në vijim të bashkëpunimit midis dy institucioneve dhe praktikave të krijuara, lidhur me procesin e verifikimit të cilësive etike, morale dhe profesionale të punonjësve të MEPJ, sipas listës së përcaktuar në Organikën e MEPJ-me dhe në Organikën Përfaqësi Diplomate, në funksion të përputhshmërisë dhe harmonizimit të dispozitave të veçanta të ligjit 23/2015, “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, me ligjin 45/2015 “Për të drejtën e Informimit mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, i kemi përcjellë MEPJ sugjerimet tona për përmirësime të ligjit 23/2015, në këndvështrimin ligjor të Autoritetit. *Është vetë institucioni i MEPJ që, mbi bazën e këtyre ndryshimeve ligjore (nëse do të miratohen nga legjislatori), do të ndërhyjë në dispozita të veçanta në Rregulloren për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë, si në procedurat e rekrutimit në Shërbimin e Jashtëm.*

- Ndryshime të mundshme në Ligjin 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Autoriteti, duke vlerësuar dhe duke konstatuar problematikën konkrete të ndeshur në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë në qershor 2017, ku nga 18 (tetëmbëdhjetë) parti politike të regjistruara në zgjedhje, vetëm dy prej tyre paraqitën kërkesë në Autoritet për verifikimin e figurës së pastërtisë të kandidatëve të propozuar nga ana e tyre (PDIU, PAP), është i gatshëm të ofrojë të gjithë kontributin apo asistencën e duhur për ndryshimet ligjore të mundshme në Kodin Zgjedhor, lidhur me çdo kërkesë të paraqitur nga subjektet e regjistruara në zgjedhjet e radhës, për qëllime të transparencës së figurës së kandidatëve gjatë fushatave elektorale dhe më gjerë. Në këtë kontekst, Autoriteti, mbi bazën e informacionit,

dijeve dhe eksperiencës teknike të përftuar si eksperiencë nga zgjedhjet e kaluara, ka përgatitur një draft/propozim për përmirësime të nevojshme të kuadrit ligjor zgjedhor, ku mbetemi të hapur dhe për variante të tjera të mundshme, për qëllime të transparencës së figurës së kandidatëve gjatë fushatave elektorale, të cilat besojmë se komisioni i posaçëm i reformës zgjedhore, do t'i materializojë në dispozita të reja ligjore. Ky draft i është përcjellë gjatë muajit nëntor 2018 edhe Kuvendit të Shqipërisë.

10.3. Ndryshime të mundshme në Vendimin nr.188 datë 04.03.2015 “Për miratimin e rregullores për sigurimin e personelit”, si dhe në PyetëSORIN e Sigurisë, në këndvështrimin ligjor të Autoritetit

Autoriteti, referuar akteve ligjore që zbatohen për procesin e administrimit të certifikatave të sigurisë dhe kryesisht, dispozitave të veçanta të shprehura në Vendimin nr. 188, datë 04.03.2015, Për miratimin e rregullores “Për sigurimin e personelit”, ka parë mundësinë e përfshirjes së AIDSSH-së në këtë proces, si “Autoritet verifikues”, ku përfshihet SHISH, Agjencia e Intelgjencës dhe e Sigurisë së Mbrojtjes, Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme, të cilat janë të specializuara për kryerjen e verifikimeve të sigurisë ndaj individëve që do të njohin, do të prodhojnë, do të ruajnë, do të administrojnë, transmetojnë, informacionin e klasifikuar.

Sa më sipër, Autoriteti vlerëson dhe e konsideron të rëndësishëm bashkëpunimin me institucionin e DSIK-së, për të punuar së bashku, lidhur me disa shtesa apo ndryshime që mund t'i bëhen Vendimit nr. 188 datë 04.03.2015, “Për miratimin e rregullores për sigurimin e personelit”, si dhe PyetëSORIT të Sigurisë, në këndvështrimin ligjor të Autoritetit.

10.4 Ndryshime të mundshme në Ligjin 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”

Nisur nga eksperiencat më të mira të institucioneve homologe në vendet e Evropës Lindore, nisur nga përgjegjësia për shërbim sa më cilësor qytetarëve, institucioneve, studiuesve dhe medias, si dhe praktikave të krijuara në zbatimin e ligjit 45/2015, AIDSSH po punon për përmirësimin e ligjit, duke bërë disa shtesa apo ndryshime në nene të veçanta të ligjit 45/2015, “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, që do të rregullojnë dhe do të mundësojnë produkt më cilësor të institucionit. Këto propozime, pas miratimit përfundimtar brenda Autoritetit, do t’i dërgohen Kuvendit të Shqipërisë.

11

**ORGANIZIMI I BRENDSHËM I
INSTITUCIONIT**

Struktura dhe organika e AIDSSH-së


Vendimi i Kuvendit nr. 95, datë 22.12.2016, për strukturën dhe organikën përcakton që Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit duhet të ketë një personel prej 60 punonjësish, ku 5 prej tyre janë Anëtarët e Autoritetit, të zgjedhur dhe të emëruar nga Kuvendi me vendimet përkatëse; Nr.79, Nr. 80, Nr. 81, Nr. 82, Nr. 83, datë 17.11.2016.

Struktura dhe organograma e AIDSSH-së është: Me ligjin nr. 109/2017, datë 30.11.2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, AIDSSH-së iu vu në dispozicion një fond pagash për 10 (dhjetë) punonjës të rinj, që e çon në 30 numrin, nga 60 të tillë të miratuar me vendimin e Kuvendit nr. 95, datë 22.12.2016 .

Vendimi i Autoritetit nr. 29, datë 26.01.2018 “Për planin e rekrutimeve për vitin 2018”, ndryshuar me Vendimet e Autoritetit nr.392, datë 25.10.2018, nr.448, datë 18.12.2018, bazuar në vendimin e Vendimin e Kuvendit nr. 95, datë 22.12.2016 për strukturën dhe organikën e AIDSSH, rregulloren “Për Organizimin dhe Funksonimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit”, nevojat e AIDSSH-së, përcaktoi edhe pozicionet përkatëse për këta 10 (dhjetë) punonjës të rinj. Mbeten pa burime financiare 30 (tridhjetë) pozicione pune të paplotësuara deri tani.

Rekrutimi i personelit dhe trajnimi i tyre

Bazuar në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, Kodin e Punës, VKM-të përkatëse, praktikat dhe udhëzimet e Departamentit të Administratës Publike (DAP), që



rregullojnë procesin dhe procedurat e rekrutimit, AIDSSH filloi dhe përfundoi procesin e rekrutimit të personelit që lejonte fondi i pagave shtesë, i miratuar në buxhetin e vitit 2018.

Në përfundim të procedurave të rekrutimit për vitin 2018, nga 10 (dhjetë) pozicionet, të mbështetura me fond pagash në buxhetin e vitit 2018, për shkak të mungesës të kandidatëve të përshtatshëm, mbeti pa u plotësuar, pa u rekrutuar, vetëm 1 (një) pozicion, ai i specialistit të sektorit të kërkesave për qëllime studimore, media, etj., në drejtorinë e mbështetjes shkencore dhe edukimit qytetar.

Gjatë vitit 2018, gjithashtu janë zhvilluar procedurat e rekrutimit për të plotësuar pozicione ekzistuese, të mbuluara me fond pagash, nga të cilat punonjësit, për arsye të konkurrimit për një pozicion tjetër të shpallur në planin e rekrutimeve për vitin 2018, kanë lëvizur brenda AIDSSH-së, ose për arsye të ndryshme janë larguar, kanë ndërprerë marrëdhëniet me AIDSSH-në. Në fillim të vitit 2019, nga pozicionet e mbuluara me fond pagash që mbeten vakante për shkak të kalimit të punonjësve ekzistues në një pozicion tjetër, të shpallur në planin e rekrutimeve 2018, bazuar në ligjin nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", VKM-të përkatëse, praktikat dhe udhëzimet e Departamentit të Administratës Publike (DAP), u shpall dhe përfundoi me shpalljen e fituesit, procedura e konkurrimit për një pozicion vakant, specialist në sektorin juridik dhe prokurimeve në drejtorinë e shërbimeve të brendshme

dhe financave.

Në fillim të vitit 2019, nga pozicionet e mbuluara me fond pagash, që janë aktualisht vakante, për shkak të largimit, ndërprerjes së marrëdhënieve të punës me AIDSSH-në për arsye të ndryshme, bazuar në ligjin nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", VKM-të përkatëse, praktikat dhe udhëzimet e Departamentit të Administratës Publike (DAP), aktualisht është shpallur procedura e konkurrimit për pozicionin e Sekretarit të Përgjithshëm.

Në fillim të vitit 2019, nga pozicionet e planit të rekrutimeve të vitit 2018, të mbuluara me fond pagash, por që mbeten vakante gjatë vitit 2018, për shkak të mungesës së kandidatëve të interesuar, është shpallur procedura e konkurrimit për një vend vakant në drejtorinë e mbështetjes shkencore dhe edukimit qytetar.

Në përfundim të procedurave të rekrutimit për vitin 2018, duke marrë parasysh pozicionet e plotësuara gjatë viteve 2016, 2017; numrin dhe pozicionet e personelit që aktualisht janë të mbuluara me fond pagash dhe janë të plotësuara; numrin dhe pozicionet të cilat janë të mbuluara me fond pagash e për momentin janë vakante, edhe pse janë shpallur procedurat e konkurrimit; pasqyra e personelit aktual, krahasuar me strukturën dhe organikën e AIDSSH-së, miratuar me Vendimin e Kuvendit nr. 95, datë 22.12.2016, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Struktura	Njësia	Totali sipas strukturës organikës	Pozicionet	Totali sipas pozicionit	Rekrutuar në 2016	Plani i rekrutimeve 2017	Rekrutuar në 2017	Plani i rekrutimeve 2018	Rekrutuar në 2018	Larguar në 2018	Plotësuar levizjet largimet 2018-2019	Organika aktuale e plotësuar	Kapaciteti aktual i personelit të njësive	
Autoriteti	Autoriteti	5	Anëtare	5	5					1	1	4	80%	
		1	Sekretare e kryetares	1		1	1					1	100%	
Sekretariati Teknik	Sekretar i Përgjithshëm	1	Sekretar i përgjithshëm	1		1	1			1	1	0	0%	
	Drejtoria e Arkivit	10	Drejtor	1				1	1				7	70%
			Përgjegjës Sektori	3		2	2	1	1					
			Specialistë	6		1	1	2	2					
	Drejtoria e Informacionit	16	Drejtor	1		1	1						5	31%
			Përgjegjës Sektori	2		1	1	1	1	1	1			
			Specialistë	13		1	1	1	1	1				
	Drejtoria Mbështetje Shkencore dhe Edukimit qytetar	6	Drejtor	1									1	17%
			Përgjegjës Sektori	1										
			Specialistë	4				2	2					
	Drejtoria e Shërbimeve të brendshme dhe financave	15	Drejtor	1									8	53%
			Përgjegjës Sektori	4		2	2			1	1			
Specialistë			6		3	3			1	1				
Punojës me Kod Pune			4		3	3								
Drejtoria e Sigurisë dhe zhvillimit teknologjik	15	Drejtor	1					1	1			3	50%	
		Përgjegjës Sektori	1					1	1					
		Specialistë	4		1	1			1	1				

Gjatë vitit 2018, bazuar në VKM nr.60, datë 31.1.2018 "Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2018 në njësitë e qeverisjes qendrore" u zhvilluan e përfunduan edhe procedurat e rekrutimit të 4 punonjësve shtesë, me kontratë të përkohshme dhe me kohë pune të pjesshme 6 orë/ditë.

Është ndërmarrë dhe ka përfunduar rishikimi, plotësimi dhe përshtatja e përshkrimeve të punës për të gjitha pozicionet ekzistuese dhe pozicionet e rekrutuara, në përputhje me kërkesat konkrete të pozicionit në AIDSSH, formën dhe modelin e kërkuar nga DAP.

Është pajisur personeli me certifikatat e sigurisë të nivelit përkatës, në përputhje me kërkesat e pozicioneve të punës.

Janë kryer dhe kanë përfunduar me sukses (vërtetuar me certifikatat përkatëse) pranë Drejtorisë të Sigurimit të Infomacionit të Klasifikuar (DSIK) trajnimet e nevojshme të lidhura me specifikën e punës së AIDSSH-së me informacionin e klasifikuar.

Gjatë vitit 2018 është kryer dhe ka përfunduar me sukses (vërtetuar me certifikatat përkatëse) pranë Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA) trajnimi i detyruar për 2 (dy) persona, punonjës të emëruar si nëpunës civilë në periudhë prove. Janë kryer dhe kanë përfunduar me sukses (vërtetuar me certifikatat përkatëse) trajnimet e nevojshme, të planifikuara për personelin, në planin e trajnimeve për vitin 2018, pranë Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA).

Është realizuar plani i trajnimeve dhe shkëmbimit të eksperiencës për vitin 2018 me organizatat homologe europiane dhe organizata të tjera ndërkombëtare që veprojnë në fushën e aktivitetit të AIDSSH. Janë zhvilluar trajnime në institucionet homologe të Gjermanisë e Çekisë, sa i takon punës me arkivin dhe përpunimin e materialeve arkivore, ndërtimin e databazës digjitale të të dhënave, po ashtu, shkëmbim përvojash me institucione të kujtesës dhe mundësi bashkëpunimi, si në institucionin homolog në Rumani, Yad Vashem, në Jeruzalem, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, etj, për harmonizim të përvojave më

të mira të vendeve përkatëse, në punën me arkivat, informacionin, komunikimin me publikun dhe politikat e kujtesës.

Janë kryer dhe kanë përfunduar me sukses (vërtetuar me certifikatat përkatëse) trajnimet e nevojshme pranë Drejtorisë të Përgjithshme të Arkivave (DPA)

Është ndërmarrë dhe ka përfunduar procesi i vlerësimit të rezultateve në punë për punonjësit e AIDSSH-së.

Sikurse shihet nga tabela e mësipërme, AIDSSH po punon me pothuajse gjysmën e kapacitetit të burimeve njerëzore të përcaktuara në Vendimin e Kuvendit Nr. 95, datë 22.12.2016.

Mungesa e burimeve njerëzore të mjaftueshme, në kuadër edhe të rritjes dita-ditës të aktivitetit dhe ngarkesës së punës të AIDSSH-së, ka sjellë vështirësi gjithmonë e më të mëdha e veçanërisht vonesa në kryerjen në kohë të misionit të AIDSSH-së për informimin e publikut dhe institucioneve.

Edhe pse shqetësimi për mungesën e personelit të mjaftueshëm është ngritur vazhdimisht pranë Kuvendit e Qeverisë, edhe pse viti 2019 është vit i zgjedhjeve për pushtetin lokal, ç'ka shton detyrimet dhe kërkesat e ligjit 45/2015, në ligjin nr. 99/2018 dt. 3.12.2018, "Për buxhetin e vitit 2019" nuk është parashikuar asnjë fond pagash për personel shtesë për AIDSSH-në.

Marrëdhëniet me jashtë

Gjatë vitit 2018 janë organizuar tryeza pune pranë Autoritetit, jo vetëm me faktorë dhe aktorë vendas, por dhe faktorë të jashtëm për mbarëvajtjen e nismave të ndërmarra, për të ndihmuar dialogun për të shkuarën, për të njohur më mirë historinë e zonave, dosjet e të cilave merren në shqyrtim dhe për të nxitur bashkëpunimin me këta faktorë, që shërbejnë si mekanizma që rrisin besueshmërinë në punën e Autoritetit dhe përgjegjësinë në shërbimin e informacionit, dhe i kanë krijuar mundësi Autoritetit që të organizojë punën për kërkimin shkencor dhe edukimin qytetar.

Më konkretisht janë kryer:

Përfundimi i marrëveshjes me Ambasadën Gjermane për sigurimin e pajisjeve të digjitalizimit të siguruara me fondin 50 mijë euro, të dhuruar nga Ambasada Gjermane;

Organizimi i vizitës të Ambasadores të Gjermanisë në Tiranë në Arkivin e SHISH-it, Arkivin e Ministrisë të Brendshme dhe në godinën e re të Autoritetit;

Organizimi i vizitës të Ambasadorit të Suedisë në Tiranë dhe Përfaqësuesit të Organizatës të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim në Shqipëri në Arkivin e SHISH-it, Arkivin e Ministrisë të Brendshme dhe në godinën e re të Autoritetit;

Organizimi i vizitës në Tiranë të Z. Roland Jahn, Komisioner Federal për dosjet e shërbimit të sigurimit të shtetit në ish-Republikën Demokratike Gjermane, në fund të muajit maj;

Bashkëpunime me PNUD për hartimin dhe paraqitjen pranë Delegacionit European në Tiranë të pikave konceptuale për aplikim për financimin e mundshëm të komponentëve të Planit Strategjik 2017-2020 të Autoritetit, veçanërisht të rikonstruksionit të godinës të re të Autoritetit;

Organizim dhe pjesëmarrje e anëtarësisë së Autoritetit në aktivitetin ndërkombëtar “Arkivat e Mizorisë- Roli i Arkivave në Drejtësinë Tranzicionale”, të zhvilluar në Oksford, Angli;

Organizim dhe pjesëmarrje e nëpunësve të Autoritetit në takimin vjetor të Rrjetit European të Autoriteteve Zyrtare për Dokumentet e Policive Sekrete dhe në Konferencën Ndërkombëtare “Dokumentet e Shërbimeve Sekrete, Realitetit, Racionalizimi, Kujtesa”, të zhvilluar në Sofje, Bullgari;

Organizimi i pjesëmarrjes së anëtarësisë së Autoritetit në ceremoninë e prezantimit të “Medaljes të Lirisë Truman-Regan” në “Memorialin e Viktimave të Komunizmit” në

Capitol Hill dhe takimeve me diasporën shqiptare, në kuadër të promovimit të punës të Autoritetit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Takime, përgatitja dhe paraqitja në Ambasaden Suedeze e konceptit në lidhje me mundësinë e financimit të projektit të rikonstruksionit të plotë apo të pjesshëm të godinës së re dhe projektit të digjitalizimit të arkivit; Bashkëpunimet e AIDSSH-së me komunitetet lokale i kanë krijuar mundësi që të organizojë punën për kërkimin shkencor dhe edukimin qytetar, në varësi të kërkesave të zonës. Aktivitetet përkatëse në Shkodër, Berat, Korçë, Tepelenë, Gjirokastër e Konispol kanë rritur vetëdijësimin e qytetarëve dhe kërkesat individuale për aplikim, duke rritur besueshmërinë në punën e Autoritetit dhe përgjegjësinë në shërbimin e informacionit.



Autoriteti vijon bashkëpunimet me institucione per kthimin në vende kujtese të kampeve të internimit, burgjeve apo vendekzekutimeve në diktaturë

12


**TË ARDHURAT DHE
SHPENZIMET, PËRFSHIRË
FONDET E PËRFITUARA NGA
DONATORËT**

Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018, AIDSSH ka punuar në mbështetje të parimeve, si:

- Mbështetje në fondet buxhetore për realizimin e qëllimit kryesor të AIDSSH-së, informimin në bazë të kërkesave të individëve të prekur, të institucioneve kushtetuese dhe autoriteteve publike.
- Mbështetje në fondet buxhetore për rritjen e performancës së personelit, nëpërmjet trajnimeve të ndryshme.
- Mbështetje në fondet buxhetore për anëtarësimin në organizmat ndërkombëtare dhe pjesëmarrjen në aktivitetet e organizuara prej tyre.
- Mbështetje me fonde buxhetore për transportin dhe mbledhjen e të gjitha dokumenteve dhe fondeve arkivore nga të gjitha arkivat e sistemit, në të gjitha qarqet e vendit.
- Mbështetje në fondet buxhetore për të siguruar transparencë dhe besueshmëri nëpërmjet informatizimit të aktivitetit të institucionit dhe publikimeve periodike.
- Mbështetje në fondet buxhetore për mbarëvajtjen e punës në AIDSSH.

Për vitin 2018, evidenca e realizimit të shpenzimeve të buxhetit për programin “Planifikim, Menaxhim dhe

Kapaciteti aktual i personelit të njësive



Administrim”, krahasuar me planin vjetor me ndryshime, paraqitet si më poshtë:

Në mijë lekë

Nr	Emërtimi	Buxheti Fillestar Viti 2018	Buxheti me ndryshimet 2018	me Viti	Realizimi faktik Viti 2018	
					Në vlerë	Në %
1	Planifikim-Menaxhim-Administrim	47 000	57 050		54 505	96 %

Përbërja e shpenzimeve buxhetore, sipas klasifikimit ekonomik të shpenzimeve, sipas buxhetit dhe realizimit faktik

të vitit 2018 jepet në tabelën e mëposhtme:

Në mijë lekë

Llog	Emërtimi	B u x h e t i Fillestar Viti 2018	Buxheti me ndryshimet Viti 2018	Realizimi faktik Viti 2018	
				Në vlerë	
600	Fondi i Pagave	28 000	29 000	28 324	98.0%
601	Kontrib. Sig. Shoq & Shënd.	4 000	4 450	4 271	96.0%
602	Mallra dhe shërbime të tjera	13 000	11 550	9 874	85 .0%
606	Trans per Buxh. Fam. & Individë		50	50	100.0%
231	Kapitale të Trupëzuara	2 000	12 000	11 986	99.8%
	T o t a l i	47 000	57 050	54 505	96%

Nga fondi i përgjithshëm buxhetor, për periudhën e raportuar, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit ka realizuar vlerën buxhetore sa më poshtë:

Fondi i Pagave dhe Sigurimeve Shoqërore, (zëri 600-601) është realizuar, në zbatim të strukturës organizative të miratuar, me Vendimin e Kuvendit nr. 95/2016, "Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimin e pagave të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish- Sigurimit të Shtetit". Pavarësisht strukturës së miratuar me Vendim të Kuvendit nr. 95/2016, në të cilën është përcaktuar numri total i punonjësve prej 60, me ligjin nr.109/2017, "Për buxhetin e vitit 2018" është miratuar numri vetëm për 30 punonjës.

Për vitin 2018, janë miratuar edhe 6 punonjës me kontratë të përkohshme, të cilët janë paguar për punën e kryer (6 orë) duke u trajtuar edhe me sigurime shoqërore.

Buxheti fillestar i pagave dhe i sigurimeve shoqërore me ligjin vjetor të buxhetit ishte i pamjaftueshëm dhe për këtë arsye, Grupi i Menaxhimit Strategjik, me shkresën nr.1021, datë 31.10.2018 drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, kërkoi rialokim fondesh brenda buxhetit të institucionit, nga zëri "Shpenzime operative" në "Paga dhe sigurime shoqërore" në vlerën 1 450 mijë lekë.

Për sa më sipër, buxheti i pagave dhe i sigurimeve shoqërore është realizuar për numrin faktik të punonjësve, respektivisht në vlerën 28 324 mijë lekë për paga, si dhe 4 270 mijë lekë për kontribute në sigurimet shoqërore e shëndetësore, rreth 97 % e fondit të planifikuar vjetor.

Niveli prej 97% është nivel shumë pozitiv për Autoritetin për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, pasi llogaritja e shpenzimeve për këtë zë dhe shtesa për fonde është bërë në mënyrë të saktë.

Fondi për shpenzime në zërin Mallra dhe Shërbime (zëri 602-606), për vitin 2018, pas ndryshimeve është në vlerën 11.550 mijë lekë.

Sipas transaksioneve të kryera në Degën e Thesarit, ky zë shpenzimesh është realizuar në vlerën 9 874 mijë lekë ose 85 % e planit total vjetor të shpenzimeve operative.

Ky fond është realizuar për: Shlyerjen e detyrimeve për shërbimet postare, të internetit dhe telefonike.

Shpenzime për blerje furnizimesh të ndryshme, si kanceleri, materiale për pastrim, tonerë për funksionimin e pajisjeve kompjuterike, printerë dhe fotokopje, etj.

Shpenzime për mirëmbajtjen e mjeteve të transportit.

Shpenzime në funksion të realizimit të qëllimit të Autoritetit, sigurimit të standardeve, si libra dhe publikime profesionale.

Shpenzime të përkthimit, printimit dhe publikimit.

Shpenzime për përfaqësimin dhe pjesëmarrjen e Kryetares, Anëtarëve dhe personelit të Autoritetit në aktivitete e takime pune të ndryshme, brenda e jashtë Shqipërisë.

Në kuadër të përmirësimit të treguesve të performancës dhe realizimit të fondeve korrente të vëna në dispozicion, Grupi i Menaxhimit Strategjik, së bashku me sektorin e prokurimit, ka vlerësuar në mënyrë permanente kostot e aktiviteteve për vitin 2018, për realizimin e objektivave afatshkurtër, duke i reflektuar në regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike, të ndryshuar. Në zbatim të planit për shpenzime dhe investime, AIDSSH ka hartuar e zbatuar edhe planin e prokurimeve, i cili gjatë vitit 2018, përmbante dy procedura prokurimi me tenderim (i klasifikuar) ndërsa mbulimi i nevojave të

tjera është realizuar nëpërmjet prokurimeve me vlera të vogla.

Fondi për shpenzime kapitale (zëri 230-231)

Nga monitorimi konstatohet se struktura e shpenzimeve kapitale sipas buxhetit fillestar është ndryshuar me shtimin e fondit për shpenzime kapitale të patrupëzuara, në vlerën 12.000 mijë lekë.

Fondi për shpenzime kapitale të trupëzuara (zëri 231)

Buxheti i akorduar për këtë zë shpenzimesh, me ndryshimet gjatë vitit buxhetor është 12.000 mijë lekë, i detajuar në dy projekte, si më poshtë:

1- Projekti M950003- llog 231, në vlerën 11.852 mijë lekë, me emërtimin “Rikonstruksion godine”.


Rikonstruksioni i godinës ka pasur interesim të madh nga ana e Autoritetit. Për këtë arsye, i gjithë fondi është prokuruar dhe është realizuar në masën 100 %.

2- Projekti M950005- llog 231, në vlerën 134 mijë lekë, me emërtimin “Mbikëqyrje punimesh”, projekt i cili ecën paralelisht me rikonstruksionin e godinës dhe është likuiduar plotësisht, me realizim 100 % të projektit.

Vlen të theksohet që për vitin 2018, në kuadër të marrëveshjes ndërmjet Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit dhe Ambasadës Gjermane, institucioni ka përfituar financime nga ky donator me pajisje informatike në vlerën 4.672.512 lekë, në kuadër të projektit për krijimin e arkivit digjital të dëshmive gojore të personave të përndjekur nga Sigurimi i Shtetit.

Për sa i takon kallëzimeve penale adresuar Autoritetit gjatë vitit raportues 2018,

Shpenzime Buxhetore



13

**KALLËZIMET PENALE DHE
PROCESET GJYQËSORE**

rezulton se nuk është ngritur asnjë kallëzim penal. Më poshtë renditen të detajuara çështjet gjyqësore të Autoritetit për vitin 2018 dhe ato në vijim:

1. Çështja gjyqësore me palë: Padiës: Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit dhe i paditur: DAT Tiranë dhe DRT Tiranë.

Pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, është marrë në shqyrtim çështja administrative me palë padiëse Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit dhe palë të Paditura: DAT Tiranë dhe DRT Tiranë me objekt: 1. Shfuqizimin/anulimin e aktit administrativ, Njoftim vlerësimi nr. 57246 prot, datë 30.10.2017 të Drejtorisë Rajonale Tiranë për deklarim të vonuar; 2. Shfuqizimin/anulimin pjesërisht të Vendimit nr. 5278/1 datë 27.12.2017 të Drejtorisë së Apelimit Tatimor për pikën 1 të këtij vendimi.

Pasi ka ballafaquar kriteret ligjore me rastin objekt gjykimi, Gjykata në vendimin e saj nr. 1042 datë 21.03.2018 konstaton se tatimpaguesi padiësi AIDSSH, nuk ka njohur, as nuk ka pasur mundësi të njohë kohën e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 136/2016 as mund të hamendësonte për efektet prapavepruese të ligjit dha as për shtrirjen e këtyre efekteve me qëllim përlllogaritjen e saktë për deklarimin e punonjësve pranë organit tatimor.

Ligji nr.136/2016 është ligji që shërben për fillimin e marrëdhënieve të punës, si dhe datën e deklarimit të punonjësve, Anëtarëve të Autoritetit. Ky ligj që ka dalë më pas nga Vendimet e Kuvendit, datë 17.11.2016, me të cilat janë zgjedhur Anëtarët e Autoritetit, nuk ekzistonte/apo kishte hyrë në fuqi në periudhën nëntor-dhjetor 2016. Pasojat e ligjit të mëvonshëm nr. 136/2016, të zgjedhjes së anëtarëve kanë sjellë pikërisht vonesat dhe kanë "legjitimuar" marrjen e masës dënim me gjobë nga pala e paditur, DRT Tiranë dhe DAT Tiranë, ndaj Padiësit, AIDSSH-së.

Gjykata mbështetur Neni 113 i ligjit nr. 9920/2008 konkludon se nuk ka shkak ligjor që pala padiëse AIDSSH të dënohet me sanksionin e parashikuar nga

ky nen.

Në përfundim të gjykimit, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë vendosi:

Pranimin e padiës: shfuqizimin/anulimin e aktit administrativ Njoftim vlerësimi nr. 57246 prot, datë 30.10.2017 të Drejtorisë Rajonale Tiranë për deklarim të vonuar;

Shfuqizimin/anulimin pjesërisht të Vendimit nr. 5278/1 datë 27.12.2017 të Drejtorisë së Apelimit Tatimor për pikën 1 të këtij vendimi me të cilin është vendosur: "Lënia në fuqi e aktit administrativ, njoftim vlerësimi 57246 prot, datë 30.10.2017 të DRT Tiranë për deklarim të vonuar në vlerën 20 000 lekë (i. Sigurime Shoqërore (E-Sig27), periudha nëntor-dhjetor 2016, gjoba sistemi 10.000 lekë; ii. Sigurime shoqërore, periudha dhjetor 2016, gjoba sistemi 5.000 lekë; iii. Tatim i mbajtur në burim, periudha dhjetor 2016, gjoba sistemi 5.000 lekë)".

2. Çështja gjyqësore me palë: Padiës: Simon Vorfi dhe i thirrur në cilësinë e palës së tretë: Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit.

Çështja gjyqësore me kërkues z. Simon Vorfi me Autoritetin për Informim, i cili është thirrur në këtë gjykim në cilësinë e Personit të tretë, pas seancës gjyqësore të mbajtur në datën 12.06.2018, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është shpallur vendimi nr. 5781 "Për deklarim moskompetence" për çështjen civile me palë kërkuese z. Simon Vorfi. Autoriteti për Informim është thirrur në këtë gjykim në cilësinë e Personit të tretë.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë, me vendimin e seancës përgatitore, datë 16.10.2018, në çështjen me Nr. Regj. Them. 31138-05640-80, ka vendosur: të ngrejë çështjen e mosmarrëveshjes për kompetencë para Gjykatës së Lartë për gjykimin e çështjes administrative me nr. 31138-05640-80.

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë me Vendimin Nr. 00-2018-1063, të datës 06.11.2018, vendosi

prishjen e vendimit nr. 5781, datë 12.06.2018, të GjRREGJT dhe të rikthejë çështjen për gjykim pranë kësaj gjykate, me të njëjtin trup gjykues.

3. Çështja gjyqësore me palë: Paditës: Janko Shelçaj dhe i paditur: Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit.

Çështja gjyqësore me palë Janko Shelçaj vs AIDSSH me objekt padie shfuqizimin e aktit administrativ, Vendimit nr. 370, datë 19.10.2018 i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, me të cilin është lënë në fuqi Vendimi nr. 75, datë 24.04.2018, i po këtij Autoriteti, drejtuar Gjykatës Administrative të Rrethit Shkodër.

Bazuar në ligjin nr.49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, neni 11, sipas të cilit “Paditë kundër veprimit administrativ shqyrtohen në gjykatën administrative të shkallës së parë, që përfshin territorin, në të cilin organi publik ka kryer veprimin administrativ që kundërshtohet”, me kërkesë të AIDSSH-së trupi gjykues ka vendosur kalimin për kompetencë tokësore pranë Gjykatës Administrative të Rrethit, Tiranë për gjykimin e çështjes. Jemi në pritje të njoftimit të datës së seancës përgatitore në Gjykatën Administrative Tiranë.

4. Çështja gjyqësore me palë: Paditës: Kozma Jano dhe i paditur: Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit

Çështja me palë Paditëse Kozma Jano kundër AIDSSH-së drejtuar Gjykatës Administrative Tiranë. Është zhvilluar në datën 03.12.2018, seanca përgatitore, ku nga pala paditëse janë dhënë shpjegimet për pretendimet e paditësit. Procesi është në vijim.

ISBN 978-9928-294-04-3



9 789928 294043